



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
“Informatikë Biznesi”  
“Universiteti i New York-ut Tiranë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Alketa Grepcka**

**Dr. Erald Piperi**

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names. The top signature is a cursive-style name, and the bottom signature is a more stylized, scribbled name.

**Dhjetor / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në: "Informatikë Biznesi"**

1	IAL aplikues:	"Universiteti i New York-ut në Tiranë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Informatikë Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr.198 datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit, për vitin akademik 2022-2023	4 PAE / 1 PAK Për sa i përket ngarkesës mësimore (87 % / 13%)
18	Numri i studentëve:	2020-2021 - 5 studentë; 2021-2022 - 13 studentë; 2022-2023 - 18 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” ofrohet në “Universitetin e New York-ut” në Tiranë. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit i hapur përmes Urdhërit të MASR Nr. 228 Prot, datë 10.07.2020. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit (FEB) përbëhet nga tre njësi bazë respektivisht:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit;

Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit. Kjo njësi ofron programe studimit duke mbuluar 2 programe studimit të ciklit të parë. Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit zotëron një staf që zë 34.7 % të numrit total të stafit akademik të FEB-së. Njësia bazë ka ruajtur në vite numrin e tij duke përbushur standartet ligjore.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” është ndërtuar mbështetur në dispozitat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 për “Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në perfundim të studimeve të tyre në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 30 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 30. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën angleze.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të specializuar në fushën e informatikës ekonomike për të krijuar specialistë dhe kërkues të përgatitur në këtë fushë.

### **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Maj 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur FEB/“New York i Tiranës” për të përbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. IAL “New York i Tiranës”, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër evidencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa

ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demireli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit, Përgjegjës të Departamentit, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, takim me stafi akademik të angazhuar në programin e studimit, takim me studentët në këtë program studimi. GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të strukturave bazuar edhe në axhendën e takimeve date 29-30.06.2023. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti i New York-ut Tiranë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 21.11.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 118/69 Prot, datë 21.11.2023. Universiteti i NewYork-ut Tiranë përcjell në ASCAL më datë 30.11.2023, me anë të shkresës me Nr.88/2 Prot, datë 22.11.2023 “ *Përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>UNYT ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. UNYT është një institucion i arsimit të lartë jopublik me autonomi e me liri akademike, i cili respekton detyrimet ligjore të përcaktuar në kuadrin ligjor të arsimit të lartë. UNYT ofron programe studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të cilat janë miratuar nëpërmjet akteve ligjore respektive. Në qendër të veprimtarisë arsimore qëndron “Edukimi i Drejtuesve të së Ardhmes”. UNYT në qendër të veprimtarisë së tij ka përkushtimin në drejtim të procesit mësimor, rritjes personale të studentëve të diplomuar dhe zhvillimit të komunitetit ku inkurajohet dhe mbështetet pjesëmarrja aktive dhe lira e shprehjes.</p> <p><i>[Ev: 1.1 UNYT Statuti 2020; 1.6 UNYT Plani Strategjik 2020-2025, Shqip]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit. Misioni i UNYT synon një zhvillim intelektual, krijues dhe personal të studentëve përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Ofrimit të një cikli gjithpërfshirës të arsimit të përgjithshëm;</li><li>Përdorimit të një larmi metodash inovatore në mesimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim;</li><li>Ofrimin e zgjidhjeve individuale të studentëve si studiues aktivë dhe krijues;</li><li>Ndërkombëtarizimin;</li></ol> <p>GVJ shqyrtoi me vëmendje misionin e programit të studimit dhe konstaton përputhshmëri më misionin e përgjithshëm të institucionit të shprehur qartë në Statut të UNYT dhe në Planin Strategjik (2020-2025).</p> <p><i>[Ev: 1.1 UNYT Statuti i Miratuar; 1.6 UNYT Plani Strategjik 2020-2025; 2.3 UNYT Arsyetim për hapjen e programit</i></p>

	<i>Bachelor BSc ne Informatike Biznesi; 1.11 UNYT Mission and Objectives;]</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat strategjike të institucionit. UNYT ka hartuar Planin Strategjik (2020-2025) mbi bazën e të cilit synon të zhvillojë programet mësimore. Plani strategjik karakterizohet nga objektiva strategjike si vijon më poshtë dhe secila prej tyre është e shoqëruar me plan veprimet përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Objektivi 1: Përpjekje për të përsosur mësimdhënien dhe shërbimet;</i></li> <li>• <i>Objektivi 2: Zgjerimi dhe mbështetja e Programit Kërkimor të UNYT dhe produktit të tij;</i></li> <li>• <i>Objektivi 3: Ruajtja dhe përmirësimi i rrjetit të partnerëve dhe marrëdhënieve;</i></li> <li>• <i>Objektivi 4: Zhvillimi i vazhdueshëm i infrastrukturës;</i></li> <li>• <i>Objektivi 5: Ruajtja e stabilitetit financiar për të patur një qëndrueshmëri institucionale;</i></li> <li>• <i>Objektivi 6: Epoka e ardhshme e arsimit;</i></li> </ul> <p><i>[Ev: 1.6 UNYT Plani Strategjik 2020-2025; 1.11 UNYT Mission and Objectives;]</i></p> <p>Institucioni garanton veprimtarinë mësimore, lirinë akademike dhe të drejtat e studentëve dhe stafit akademik përmes klauzolave ligjore të shprehur në Statut të UNYT. Statuti është dokumenti ligjor i hartuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi që lejon një institucion të arsimit të lartë jopublik të ushtrojë veprimtarinë e tij. GVJ konstaton se përmbajtja e saj e ndarë në 11 kapituj të rëndësishëm përcakton veprimtarinë e të gjithë strukturave të ngritur në institucion dhe harmonizon punën e secilës përmes përmes neneve ligjore. Vlen të përmendim kapituj më të rëndësishëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Strukturën organizative të universitetit;</i></li> <li>2. <i>Organizimin akademik dhe administrativ;</i></li> <li>3. <i>Komisionet e përhershme dhe njësinë e sigurimit të cilësisë;</i></li> <li>4. <i>Organizimet administrative;</i></li> <li>5. <i>Personeli i universitetit;</i></li> <li>6. <i>Njësitë administrative dhe njësitë ndihmës akademike;</i></li> <li>7. <i>Organizimi i studimeve, ciklet dhe diplomat;</i></li> <li>8. <i>Studentët dhe te dhënat mbi studentët;</i></li> <li>9. <i>Sigurimi i jashtëm i cilësisë, akreditimi dhe auditimi i jashtëm;</i></li> </ol> <p><i>[Ev: 1.1 UNYT Statuti i Miratuar]</i></p>



	<p>UNYT ka hartuar dhe vënë në zbatim Rregulloren Akademike të Universitetit i cili konsiderohet si një dokument themelor që përcakton veprimtarinë arsimore institucionale në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në insitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Mbi bazën e saj janë hartuar edhe rregulloret për njësitë kryesore dhe njësitë bazë. GVJ shqyrtoi me vëmendje rregulloren e programit të studimit dhe evidenton se përmbajtja e saj specifikon të drejtat dhe detyrat e palëve pjesë përbërëse e procesit mësimor në këtë program dhe konstaton se kjo rregullore është në akordancë me rregulloret akademike të institucionit.</p> <p><i>[Ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit te Ekonomise dhe Biznesit; 1.9 Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit dhe e-Biznesit; 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi;]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ përmes takimeve të zhvilluara dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se UNYT zotëron përvojën dhe kapacitetet e duhura që garantojnë zhvillimin e programeve mësimore në këtë institucion. Në përputhje me Planin Strategjik 2020-2025 UNYT ka riorganizuar strukturat e saj akademike duke krijuar tre fakultete secila me nga tre departamente.</p> <p>Përberja e njësive kryesore në UNYT është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;</li> <li>• Fakulteti i Ekonomiksit dhe Biznesit;</li> <li>• Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;</li> <li>• Instituti për Kërkime Europiane dhe Ballkanike;</li> </ul> <p>Programi i studimit zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit i cili përbëhet përmes ristrukturimit në tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Administrim Biznesit;</li> <li>• Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;</li> <li>• Departamenti i Informatikës se Biznesit dhe e-Biznes;</li> </ul> <p><i>[Ev: 1.1.1 UNYT Organigrama; 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI; 1.5 UNYT_RVB_Vleresim Institucional_Shqip].</i></p> <p>Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit) ku zhvillohet edhe programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” zotëron personel akademik me përvojë dhe eksperiencë për programet mësimore.</p> <p>Konkretisht në tre vitet e fundit janë angazhuar:</p>

<b>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b>	<b>2020-2021 PAE/PAK</b>	<b>2021-2022 PAE/PAK</b>	<b>2022-2023 PAE/PAK</b>
Departamenti i Administrim Biznesit	7/1	7/3	7/8
Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës	7/3	7/5	8/5
Departamenti i Informatikës se Biznesit dhe E-Biznes	7/4	7/0	8/0
<b>Total</b>	<b>29</b>	<b>29</b>	<b>36</b>

UNYT ka krijuar në drejtim të programit të studimit një infrastrukturë të duhur. Procesi mësimor zhvillohet në ambiente në përputhje me standartet për salla leksioni, seminare dhe orë laboratorike [vizitë ne institucion, takime në institucion];

Strukturat akademike ndihmohen nga disa njësi ndihmëse administrative u përmendim; Zyra e Financës, Sekretaria Mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Operacionale, Zyra e Mbështetjes me Teknologji Informacioni, Zyra Alumni dhe e Karrierës, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Biblioteka etj. [Ev: 1.5 UNYT\_RVB\_Vleresim Institucional\_Shqip;]

**Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe

Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit në Departamentin e Informatikës se Biznesit dhe e-Biznes-it. Bazuar në të dhënat e gjetura në database të Ascal dhe të dhënat e paraqitura nga institucioni konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit ofron 7 programe të ciklit të parë “Bachelor”, 2 programe MSc, 1 Program Dr. ndërsa Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe E-Biznes si një departament i ri i ofruar nga riorganizimi i bërë nga institucioni zhvillon vetëm 2 programe studimi në ciklin e parë. GVJ konkludon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.



udhëzimeve kombëtare e evropiane.	[Ev: <a href="http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/programe_t_shiko.php?id=3457">http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/programe_t_shiko.php?id=3457</a> 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit të ciklit të parë "Informatikë Biznesi" ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit. GVJ konkludon se programi i studimit është hartuar bazuar mbi Strategjinë e Institucionit, objektivat e programit të studimit dhe garanton lirinë akademike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur dhe mendimet e mbledhura në takimet e zhvilluara në insitucion dhe evidenton një mirëfunksionim të strukturave të ngritura pëmes vendimeve të Senatit Akademik. Statuti i cili është dokumenti bazë është hartuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe përmes neneve në përmbajtjen e tij përcakton qartë formimin e strukturave, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej tyre.</p> <p>NYUT përbëhet nga katër njësi kresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;</li> <li>• Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;</li> <li>• Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;</li> <li>• Instituti për Kërkime Evropiane dhe Ballkanike;</li> </ul> <p>Neni 9 në Statut përcakton edhe njësitë bazë për secilin fakultet. Në këtë nen evidentohen edhe njësitë ndihmës akademike. Konkretisht këtë rol e luajnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qendra e Matematikës;</li> <li>• Qendra e Shkrimit Akademik;</li> <li>• Qendra e Këshillimit të Studentëve;</li> <li>• Zyra Alumni dhe Karrierës;</li> </ul>

- Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Dekani i Studentëve;

Neni 9 përcakton edhe njësitë administrative në njësitë kryesore në shërbim të programeve të studimit ku evidentojmë në shërbim të programit të studimit:

- Zyra e Financës;
- Sekretaria Mësimore;
- Zyra e Çështjeve Studentore;
- Zyra e Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun;
- Zyra e Burimeve Njerëzore;
- Zyra e Shërbimeve Operacionale;
- Zyra e Mbështetjes me Teknologji Informacioni;
- Biblioteka;

Nenet në vijim të këtij kapitulli japin rolet dhe përgjegjësitë e secilës strukturë dhe përfaqësimin e tyre. Në shërbim të dispozitave ligjore të shprehur në Statut janë edhe rregulloret të cilat konsiderohen si dokumenta themelore të veprimtarisë konkrete institucionale dhe janë të hartuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. GVJ konstaton se funksioni i strukturave të ngritur është në akordancë me përmbajtjen e rregulloreve të cilat kanë për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore – shkencore dhe administrative në UNYT në përputhje me objektivat dhe misionin e vet institucionit.

Kapitulli 6 në Statut përcakton edhe dispozitat ligjore në lidhje me personelin e punësuar në UNYT. Neni 40 vë në qendër të politikave të UNYT mbrojtjen dhe nxitjen e lirisë akademike në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë. GVJ konstaton se të drejtat dhe detyrimet e veçanta të personelit akademik janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit si edhe në kontratat të hartuara në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës [Ev: 1.1 UNYT Statuti i Miratuar; 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 4.28 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar; 4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë të pjesshme; 4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar].

Bazuar në dispozitat ligjore institucionale zhvillohet edhe monitorimi dhe ndjekja e procesit mësimor. Mbledhjet dhe

	<p>analizat janë praktika të cilat në mënyre frekvente organizohen në njësinë bazë, njësinë kryesore dhe shprehen në formë të raporteve vjetore. GVJ u njoh me raportin vjetor për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 dhe kontaton se përmbajtja e tyre është tregues i analizës së zhvilluar nga njësi bazë në drejtim të përcaktimit të arritjeve pozitive, problematikave dhe hartimit të plan veprimit në drejtim të përmirësimit.</p> <p><i>[Ev: 1.14 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2020-2021; 1.18 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2021-2022].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UNYT konsideron si komponent “D” në Strategjinë e Zhvillimit (2020-2025) ndërkombëtarizimin. Në përputhje me qëllimet e ndërkombëtarizimit UNYT është bërë anëtare e dy shoqatave të rëndësishme universitare: Shoqata e Universiteteve Evropiane (EUA) dhe Shoqata Universitare Ballanike (BUA) të cilat nxisin bashkëpunimin midis institucioneve të arsimit të lartë në Ballkan dhe ne Evropë</p> <p><i>[Ev:1.6 UNYT Plani Strategjik 2020-2025].</i></p> <p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve institucioni ka vendosur edhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Staf i PAE i angazhuar në programin e studimit vjen nga universitete brenda vendit kryesisht nga Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Durrës përmes marrëveshjeve të arritura institucionale <i>[Takime me stafin akademik; Ev: 2.5 Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB BI., tabela nr.6.1,6.2 dhe 6.3].</i> Lektorë të huaj ftohen vazhdimisht dhe janë rubrikë e veçantë në raportet vjetore që njësi bazë harton në përfundim të vitit akademik <i>[Ev: 1.14 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2020-2021; 1.18 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2021-2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë e programit mësimor. Nën emërtimin “Intership” që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë studentëve u krijohet mundësia të zhvillojnë praktikën pranë një kompani biznesi. Në këtë drejtim, në funksion të mbështetjes së studentëve dhe aftësimit praktik të tyre njësi bazë bashkëpunon drejtpërdrejt me 26 kompani biznesi të cilat japin ndihmë konkrete për studentët e programit të studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” dhe 18 marrëveshje të cilat shërbejnë për të gjithë programët e studimit.</p>

praktikave të punës apo stazhit etj.	<i>[Ev: 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Bl., tabela nr.5].</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se njësia bazë në përfundim të vitit akademik harton edhe raportet vjetore në lidhje me ecurinë e programit të studimit. Pjesë e rubrikave të shprehur në raport janë edhe arritjet përmes lektoreve të huaj të ftuar nga departamenti për studentët në këtë program studimi. Konkretisht per dy vitet akademike 2020-2022 janë ftuar 5 lektorë të huaj ku përmendim nga universiteti i Romës (Itali) të cilët kanë diskutuar në kuadër të kursit HRS-MBA “The role of implicit cognitive biases in HR selection and hoë to assess soft skills”, lektore e ftuar nga Gjinishi Consulting shpk e cila ka ofruar një leksion të hapur në lidhje me “Menaxhimin e Projektit ne Biznes: Auditimi i projektit dhe problematikat”. GVJ konstaton se “Intership” është modul i veçantë i vlerësuar me 10 orë mësimore dhe 90 orë pranë një institucioni/kompani biznesi. Si pjesë e programit mësimor monitorimi dhe analizimi i saj shprehet në raportet vjetore në sesionet “Learning Enhancement” dhe “Curricula Development” .</p> <p><i>[Ev: 1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se UNYT ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë për strukturat të cilat janë përgjegjëse për procesin mësimor, monitorimin dhe vlerësimin e tij brenda institucionit. Programi mësimor garanton përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit ku një komponente e rëndësishme është edhe ndërkombëtarizimi. Programi mësimor synon aftësimin praktik të studentëve dhe praktika profesionale luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR




<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit i cili ndjek një kurrikul të veçantë ku janë përcaktuar qartë lëndët, orët mësimore, orët laboratorike, projektin e diplomës. Organizimi i Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”, si dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të Parë të studimeve. Programi përgatit studentët me njohuritë dhe aftësi në përputhje me kriteret e vendosura. Ky program ofrohet në akordancë të plotë me Ligjin Nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe me aktet nënligjore. Studimet organizohen në lëndë e module dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programet janë të organizuara në zbatim të të gjitha udhëzimeve të MAS.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit përcakton:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Programi i studimit është krijuar sipas standarteve dhe metodave në përputhje me sistemin evropian të Arsimit të Lartë (neni 20);</li> <li>b. Viti akademik është i ndarë në dy semestra (neni 3);</li> <li>c. Çdo semestër përfshin 15 javë mësimore, përfshirë provimin e ndërmjetëm dhe atë përfundimtar (neni 3);</li> <li>d. Gjuha e mësimdhënies është gjuha angleze (neni 4);</li> <li>e. Lëndët e programit të studimit jepen me kredite (ECTS) (neni 19)</li> <li>f. Numri i krediteve për semestër është 30 (ECTS) dhe për një vit akademik është 60 ECTS (neni 19);</li> <li>g. Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 180 ECTS;</li> <li>h. Teza e diplomimit ka 8 ECTS dhe praktika mësimore ka 4 ECTS;</li> </ol> <p><i>[Ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale</p>	<p>Ky program studimi i përmbush kriteret e vendosura, pasi ofron formimin e shprehive të veçanta të cilat studentët mund ti përdorin në një varietet të gjerë profesionale. Ashtu siç përshkruhen dhe në rregulloren e programit të studimit si</p>



<p>e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>objektiv kryesor i programit të studimit është pajisja e studentëve me njohuri, aftësi dhe eksperience të cilat i ndihmojnë ata të aplikojnë në sistemet e informacionit dhe teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe biznesit për nevojat e bizneseve në vendimarrje. Në përfundim të studimeve studenti synohet të punojë si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Menaxher projektesh;</li> <li>Analist biznesi;</li> <li>Analist sisteme informacioni;</li> <li>Zhvillues sistemesh (softëare, database, web);</li> <li>Administrator sistemesh;</li> <li>Administrator biznesi etj;</li> </ol> <p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson studentet të vazhdojnë studimet pasuniversitare të ciklit të dytë Master Profesional ose Shkencor ndonëse theksojmë që njësia bazë nuk ofron ende programe të ciklit të dytë. Në përfundim të programit të studimit studentët janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Analizojnë skenarë komplekse dhe të zhvillojnë analiza të detajuara të sistemeve softëare për menaxhimin e këture skenareve;</li> <li>Tregojnë kompetencë të lartë në teknikat e optimizit të zgjidhjeve softëare dhe të përmirësimit të informacionit;</li> <li>Tregojnë njohuri të shkëlqyera të sistemeve informative dhe atyre operative dhe funksionit të tyre;</li> <li>Të kenë njohuri të mira në projektiin e strukturave të të dhënave dhe në analizën dhe projektimin e bazave të të dhënave;</li> <li>Të kenë njohuri të mira në sistemet softëare të biznesit;</li> <li>Njohuri të mira në fushën e kontabilitetit financiar dhe menaxherial;</li> <li>Të tregojnë kompetencë të lartë në teknikat algoritmike dhe në analizën e kompleksitetit të algoritmeve;</li> </ol> <p><i>[Ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” është i organizuar në disiplina mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese në 5 kategori, nga A – E. Të gjitha disipinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, E C, D dhe E janë të detyrueshme. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje</p>



ngarkesën përkatëse në kredite.

shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmblyëse që në rastin konkret është projekti i Diplomës. Programi është në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar [Ev: 2.1 UNYT Plani mesimor].

Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive në ECTS për programin e studimit është si më poshtë:

Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi
A	Lëndë Bazë	36	20%	15-20 %
B	Lëndë karakterizuese	96	53.3 %	50-55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	22	12.2 %	12-15 %
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	18	10%	10-15 %
E	Detyrime përmblyëse/ Provimi perfundimtar	8	4.5%	3-5 %

Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (neni 23) në UNYT ofrohen 4 lloje lëndësh në programin e studimit:

- 1) Lëndë të detyrueshme;
- 2) Lëndë me zgjedhje të nivelit të departamentit;
- 3) Lëndë me zgjedhje të nivelit të Fakultetit;
- 4) Lëndë me zgjedhje të nivelit Universitar;

Lëndët me zgjedhje zgjidhen nga student sipas fushës së interesit bazuar edhe në aprovimin e marrë nga Këshilluesi Akademik. [Ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor ne Informatike Biznesi].

Në këtë program studim ofrohen në të tre kategoritë e lëndëve me zgjedhje 37 lëndë. GVJ evidenton një mungesë të lëndëve me zgjedhje në fushën e informatikës dhe të biznesit. Konkretisht ofrohen vetëm dy lëndë në këtë fushë (Administrim i sistemeve dhe Programim ne C) dhe katër lëndë në fushën e ekonomisë së biznesit:

1. Sisteme informacionit të biznesit;

	<p>2. Etika e Biznesit; 3. Lidershipi; 4. Menaxhimi i operacioneve;</p> <p>ndësa pjesa tjetër e lëndëve i përket lëndëve me zgjedhje në nivel universitar. Në takimin e zhvilluar në institucion u pranua që duhet zgjeruar më shumë fusha e lëndëve me zgjedhje në nivel departamenti/ fakulteti.</p> <p><i>GVJ rekomandon të zgjerohet numri i lëndëve me zgjedhje në fushën e informatikës në nivel departamenti.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. GVJ konstaton perfshirjen e praktikës profesionale nën emërtesën “Intership” të përfshirë në kategorinë “D” dhe të vlerësuar më 4 ECTS. Në programin e studimit Intership është paraqitur me 2 provime (evidentuar edhe në syllabus) dhe në lidhje me llojin e provimit sqarime u bënë në takimet në institucion. Në aspektin e provimit janë marrë në konsideratë disa elemente si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Përmbytja në lidhje me intershipin – 40%</li> <li>2) Ditari në lidhje me ecurinë – 15%</li> <li>3) Përgatitja e raportit – 10%</li> <li>4) Prezantimi i raportit – 20%</li> </ol> <p>Në vlerësimin final edhe raporti i hartuar nga punëdhënësi [Ev: 2.14 Syllabuset e Lendëve; 1.16 UNYT Raporti i Internship].</p> <p>Projekti i diplomës zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të trete dhe futet në kategorinë “E” me 8 ECTS. Njësia bazë ka hartuar edhe një syllabus në lidhje me projektin e diplomës [Ev: 2.14.1 Syllabus Projekti Final] dhe zhvillimi i saj përcaktohet qartë në rregulloren e hartuar për “Projektin e Diplomës” [Ev: 3.3 UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit; 3.2 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzime</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i përgjithshëm i disiplinave të nevojshme për t’u diplomuar, së bashku me intership-in dhe projektin final të diplomës është 30. Forma e organizimit të studimeve bazohet në Rregulloren e programit të studimit e cila në themel të përmbytjes së saj ka Rregulloren Institucionale të UNYT [Ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-</p>

<p>të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><i>Biznesit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit te Ekonomise dhe Biznesit; 1.7 Rregullorja e Universitetit].</i></p> <p>GVJ konstaton se pranimi i studentëve bëhet në akordancë me kriteret e përcaktuara në ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kapitulli “Pranimi i Studentëve” në rregulloren e programit të studimit përcakton kriteret e pranimit për studentët shqiptarë dhe të huaj. UNYT si IAL jopublik nuk gëzon financimin me status të vecantë. UNYT ofron bursa në lidhje me studentët të cilët konsiderohen në kategorinë “status i veçantë” dhe kriteret për përfitim të tyre jepen në kapitullin “Tarifat e shkollimit dhe bursat” në rregulloren e programit të studimit [Ev; 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p><b>Jo e aplikueshme</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MASR. Ky program i përket kodit: <b>63BA0688A</b></p> <p>[Ev: 1.3 UNYT Kodifikimet Nr. Prot. 55]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p><b>Jo e aplikueshme</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit. GVJ konkludon si vijon më poshtë:</i></p>

	<p>a. Kurrikula e programit mësimor është e hartuar në përputhje me kornizat ligjore në fuqi. Ajo përcakton qartë lëndët, orët mësimore, orët laboratorike, projektin e diplomës;</p> <p>b. Lëndët në programin mësimor janë të vlerësuara sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>c. Përmes këtij programi studenti ka mundësi të aftësohet në fushën e informatikës së biznesit duke ju hapur një spektër i gjerë në drejtim të thellimit të njohurive master ose në drejtimtë punësimit në përfundim të studimeve të tyre.</p> <p>d. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>e. Ndonëse programi mësimor është i organizuar në disiplina mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese në 5 kategori (A-E), duke konsideruar numrin e pakët të lëndëve me zgjedhje në fushën e informatikës <u>GVJ rekomandon rritjen e numrit të tyre në këtë drejtim.</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Organizimi, struktura dhe funksionimi i Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë janë përcaktuar qartë në Statut. GVJ konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë janë të shprehur qartë në bazat ligjore të rregulloreve përkatëse. Dispozitat e këtyre rregulloreve zbatohen nga njësia kryesore dhe njësitë bazë. Rregulloret janë hartuar në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë” në Republikën e Shqipërisë, VKM dhe statutin e UNYT. [Ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 1.1 UNYT Statuti 2020].</p> <p>Programi i studimit bachelor në “Informatikë Biznesi” zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit në Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznes-it. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga tre</p>

departamente të riorganizuar sipas vendimit të Senatit Akademik të UNYT nr.62 datë 12.02.2020 dhe janë si vijon më poshtë:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
3. Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit;

Bazuar edhe në kuadrin ligjor në fuqi GVJ konstaton se njësia kryesore përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me stafin akademik të angazhuar më kohë të plotë në departamente. Për tre vitet akademike konstatohet një rritje të numrit të stafit akademik (PAE) në departamentin e Ekonomiksit dhe Financës dhe në Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit.

<b>IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b>			
<b>2020-2021</b>			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti Administrim Biznesi	7	1	8
Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës	7	3	10
Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit	7	4	11
<b>Total</b>	<b>21</b>	<b>8</b>	<b>29</b>

<b>IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b>			
<b>2021-2022</b>			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti Administrim Biznesi	7	3	10
Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës	7	5	12
Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit	7	-	7
<b>Total</b>	<b>21</b>	<b>8</b>	<b>29</b>

**IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit**

2022-2023			
Njësia Bazë	PAE	PAK	Total
Departamenti Administrim Biznesi	7	8	15
Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës	8	5	13
Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit	8	-	8
<b>Total</b>	<b>23</b>	<b>13</b>	<b>36</b>

Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit ku zhvillohet edhe programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” ndonëse plotëson detyrimet ligjore për numrin e stafit akademik të punësuar më kohë të plotë ka ende për të zhvilluar në drejtim të rritjes së gradave shkencore (aktualisht 3 pedagoge janë me Msc) në krahasim me stafin akademik të dy njësive të tjera bazë. Nga raportet vjetore të pasqyruara nga institucioni për vitet 2020-2021, 2021-2022, GVJ konstaton në fund të çdo viti një largim të stafit akademik me kohë të plotë dhe me grada shkencore Dr. / Prof. Asoc dhe fillimin e procedurave për punësim të ri. Gjithashtu GVJ evidenton në analizat SWOT në këto raporte të hartuara nga ana e njësisë bazë si pikë e dobët mungesa e stafit akademik.

*GVJ rekomandon që institucioni duhet të gjejë mekanizmat e duhura për sigurimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë dhe të japë mbështetjen e duhur për rritjen e gradave shkencore të tij*

UNYT është bërë pjesë e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendimin nr.61 datë 18.12.2020 ka marrë vlerësimin “Pozitiv” me një kohëzgjatje 6 vite dhe afat përfundimtar të vlefshmërisë së institucionit deri në datën 17.12.2026. Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” është liçensuar me Urdhër Nr.198 datë 03.07.2020 dhe i nënshtrohet për herë të parë procedurës së akreditimit [Ev: 1.2 UNYT Vendim Senati Nr.62; 6.12 UNYT Akreditimi Institucional i UNYT\_VBA nr. 61 date 18.12.2020]

[1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022].

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit

UNYT ka të përcaktuar qartë angazhimin dhe rolin e stafit ndihmës akademik dhe administrativ në Statut dhe në rregulloret përkatëse. Kapitulli 7 në Statut “Njësitë



<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Administrative dhe Njësitë Ndihmës Akademike” dhe kapitulli D “Struktura Administrative” në Rregulloren e Institucionit japin qartë rolin e strukturave në institucion [1.1 UNYT Statuti i Miratuar; 1.7 Rregullorja e Universitetit].</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit ku zhvillohet edhe programi i studimit angazhon një staf ndihmës akademik dhe administrativ në mbështetje të procesit mësimor. Aktualisht 9 personel ndihmës akademik angazhohen në njësinë kryesore për të dhënë asistencë stafit akademik dhe studentëve gjatë procesit mësimor [2.5 Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB BI]. Nga të dhënat e gjetura në institucion GVJ konstaton si vijon më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 683 1369 1014"> <thead> <tr> <th colspan="2"><b>IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b></th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Stafi ndihmës akademik/administrativ</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	<b>IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b>		Viti akademik	Stafi ndihmës akademik/administrativ	2020-2021	16	2021-2022	18	2022-2023	9
<b>IAL UNYT/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit</b>											
Viti akademik	Stafi ndihmës akademik/administrativ										
2020-2021	16										
2021-2022	18										
2022-2023	9										
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit bazuar edhe në nenin 15 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe në nenin 18 të rregullores së programit të studimit ka një Këshillues Akademik i cili emërohet nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Nga takimet me stafin akademik konstatohet rolin e tij në drejtim të regjistrimit të tyre, ndihmën në drejtim të udhëzimit të studentëve për lëndët me zgjedhje dhe ndjekjen e punës akademike gjatë procesit mësimor [1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi].</p>										
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit ku zhvillohet edhe programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015. Kjo njësi bazë angazhon staf akademik me përvojë dhe eksperiencë. GVJ konstaton se ndonëse njësi bazë plotëson detyrimet ligjore për numrin e stafit akademik të punësuar më kohë të plotë, institucioni duhet të gjejë mekanizmat e duhura për sigurimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë dhe të japë mbështetjen e duhur për rritjen e gradave shkencore të tij.</p>										


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit disponon të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të parë "Informatikë Biznesi". GVJ konstaton si më poshtë dokumentacionin më kryesor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statut të UNYT;</li> <li>- Rregullore të UNYT;</li> <li>- Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit;</li> <li>- Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit;</li> <li>- Rregullore e programit të studimit "Informatikë Biznesi";</li> <li>- Plani mësimor i programit të studimit "Informatikë Biznesi";</li> <li>- Syllabuset e lëndëve për programin e studimit të ciklit të parë "Informatikë Biznesi";</li> <li>- Kalendari akademik mësimor 2022-2023;</li> <li>- Rregullore e projektit të diplomës;</li> <li>- Detyrat e pedagogëve udhëheqës;</li> <li>- Syllabusi i projektit final;</li> <li>- Ngarkesa mësimore stafit akademik;</li> <li>- Personeli akademik i angazhuar në çdo vit akademik dhe CV përkatëse të tyre;</li> <li>- Raportet vjetore të departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit;</li> <li>- Procedurat e zhvillimit të provimeve;</li> <li>- Protokolli i provimeve;</li> <li>- Platforma e zhvillimit të provimeve;</li> <li>- Raporti i intershipit;</li> <li>- Procedurat e lëshimit të diplomës;</li> <li>- Kodi i ndershmërsisë së studentit;</li> <li>- Broshura dhe informime në ëbsite;</li> <li>- Vendime të njësisë kryesore dhe bazë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Vendime të Senatit Akadmeik në lidhje me procesin mësimor;</i></li> <li>- <i>CV të stafit akademik;</i></li> </ul> <p>Të gjitha këto dokumente ruhen në Zyrën e Fakultetit dhe të Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit dhe janë në dispozicion të stafit akademik si dhe atij administrative. GVJ konstaton se një pjesë e këtyre të dhënave janë bërë publike duke qenë të aksesueshme në faqen e internetit të institucionit</p> <p>[<a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/business-informatics/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/business-informatics/</a>].</p>																																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të parë të studimeve, siç janë të përcaktuara në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi është i ndërtuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura. Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive në të cilat përfshihen lëndët dhe modulet është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A: 36 ECTS;</li> <li>- Kategoria B: 96 ECTS;</li> <li>- Kategoria C: 22 ECTS;</li> <li>- Kategoria D: 18 ECTS;</li> <li>- Kategoria E: 8 ECTS;</li> </ul> <p>GVJ konstaton se pesha e lëndëve në kategorine “A” dhe “B” është 73.3% duke plotësuar kriterin ligjor mbi 70%.</p> <p>Për këtë program studimit GVJ konstaton një shpërndarje të duhur të lëndëve sipas disiplinave në çdo semestër.</p> <table border="1" data-bbox="592 1442 1369 1939"> <thead> <tr> <th></th> <th>Disiplin a “A”</th> <th>Disiplin a “B”</th> <th>Disiplin a “C”</th> <th>Disiplin a “D”</th> <th>Disiplin a “E”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Semestr i I</td> <td>2</td> <td>1</td> <td></td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestr i 2</td> <td>1</td> <td>3</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestr i I</td> <td>1</td> <td>4</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestr i 2</td> <td>1</td> <td>3</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Semestr i I</td> <td></td> <td>3</td> <td>2</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Disiplin a “A”	Disiplin a “B”	Disiplin a “C”	Disiplin a “D”	Disiplin a “E”	Semestr i I	2	1		2		Semestr i 2	1	3		1		Semestr i I	1	4				Semestr i 2	1	3		1		Semestr i I		3	2		
	Disiplin a “A”	Disiplin a “B”	Disiplin a “C”	Disiplin a “D”	Disiplin a “E”																																
Semestr i I	2	1		2																																	
Semestr i 2	1	3		1																																	
Semestr i I	1	4																																			
Semestr i 2	1	3		1																																	
Semestr i I		3	2																																		

Semestr i 2	1		2	1	1
<b>Total</b>	<b>6</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>1</b>

Studimet janë organizuar në lëndë e module dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programet janë të organizuara në përputhje me të gjitha udhëzimet e MAS. Gjuha e programit mësimor është gjuha angleze. Numri i lëndëve është 28, duke shtuar edhe praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, janë 30 dhe format e testimit janë 28.

Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi zgjat tre vite me gjashte semestra, dy në të parin, dy në vitin e dytë dhe dy në vitin e tretë. Çdo semestër ka 30 ECTS, ndërsa viti akademik 60 ECTS. Rregullorja e programit të Studimit saktëson qartë në nenin 19 se studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 180 ECTS. Sipas planit mësimor në vitin e dytë, përgjatë gjithë semestrit të dytë studenti frekuenton “Intership” e cila është 4 ECTS, ose 90 orë, ndërkohë që po në fund të semestrit të dytë të viti të tretë ai mbron edhe temën e diplomës e cila është 8 ECTS. Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:

- Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese;
- Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave;
- Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor dhe jashtë auditorit;
- Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare dhe detyra/projekte kursi;

GVJ nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit mësimor konstaton:

- Mesimi zhvillohet në 15 javë kalendarike;
- Ngarkesa mësimore totale është 4500 orë;
- Ngarkesa në auditor është 1355 orë;
- Ngarkesa jashtë auditorit është 3145 orë;

	<p>Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën mbi 20%. Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u theksua nevoja për përmirësim, futjen e lëndëve të reja në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Një vëmendje e veçantë ju kushtua në takime mënyra e organizimit të orës mësimore. Kryesisht zhvillohen 1-1.5 orë leksione dhe më pas vijohet me orët e ushtrimeve. Studentët bashkohen me grupe të tjera jashtë programit për lëndët e njëjta dhe me kredite të njëjta. Kjo është një procedurë e aprovuar por për të cilën GVJ nuk gjeti evidence.</p> <p><i>[Ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; 1.12 UNYT Ngarkesa mesimore 2020-2021; 1.12.1 UNYT Ngarkesa mesimore 2021-2022; 1.12.2 UNYT Ngarkesa mesimore 22-23 BI; 2.1 UNYT Plani mesimor; takime në institucion].</i></p>																								
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve jepen në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Kapitulli B “Programet e studimit dhe procedurat e pranimit” përcaktojnë qartë kriteret në lidhje me kutotat e pranimit të studentëve. Si kriter të përgjithshëm për pranimin e studentëve në programin e studimit të cilit të parë e ka çdo kandidat që ka përfunduar me sukses Arsimin e Mesëm dhe plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me vendim të Keshillit të Ministrave në përputhje me nenin 74 të ligjit nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë”. Për çdo vit akademik institucioni paraqet edhe kuotat e pranimit të studentëve për çdo program studimi.</p> <table border="1" data-bbox="595 1451 1369 1933"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Total i kuotave të pranimit</th> <th>Student ë brenda Shqipërisë</th> <th>Kosovë</th> <th>Maqedoni</th> <th>Shtetas të huaj</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>15</td> <td>13</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>17</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>25</td> <td>19</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Total i kuotave të pranimit	Student ë brenda Shqipërisë	Kosovë	Maqedoni	Shtetas të huaj	2020-2021	15	13	1	-	1	2021-2022	17	1	3	1	2	2022-2023	25	19	3	1	2
Viti akademik	Total i kuotave të pranimit	Student ë brenda Shqipërisë	Kosovë	Maqedoni	Shtetas të huaj																				
2020-2021	15	13	1	-	1																				
2021-2022	17	1	3	1	2																				
2022-2023	25	19	3	1	2																				

Kriteret e pranimit vendosen çdo vit nga Senati Akademik. GVJ u njoh me kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024 në UNYT dhe konstaton si vijon më poshtë:

- a. Kandidatët pranoen të kenë mbaruar arsimin e mesëm me notën mesatare 6.5;
- b. Kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mal i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci që aplikojnë në programin e studimit nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare;
- c. Si kriter i veçantë duke konsideruar që programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze zbatohet kriteri i pranimit me testim institucional ose certifikim të njohjes se gjuhës angleze niveli B1;

[Ev: 5.10 UNYT Vendim Senati per Kriteret e Pranimit 2022-2023; 5.10.1 UNYT Vendim Senati per Kriteret e Pranimit 2023-2024; 5.10.2 UNYT Vendim Senati per Kriteret e Pranimit 2024-2025;]

Procedurat e transferimit jepen qartë në Regulloren e studimit. Neni 7 I tij. Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe shqyrtimin e evidencave në lidhje me regjistrimin e studentëve kontatojmë të dhënat si vijon në tabelle.

Sipas viteve akademike	Të regjistruar	Të transferuar	Të larguar	Ndërpre të studimet	Tot
20-21	5	-	-		5
21-22	15	5	2		10
22-23	19	2 (2 ndryshim dege )	2	1	14
<b>Total</b>			<b>32</b>		

**Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në

GVJ u njoh me programet lëndore (syllabuset) e paraqitur nga institucioni. Diskutime në lidhje me to u zhvilluan edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe përfaqësues të institucionit. Për programin e studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” institucioni ka paraqitur 30 syllabuse ku përfshihet edhe intershipi dhe projekti final i diplomës. Në përgjithësi institucioni i përmbahet formatit të kërkuar nga institucionet përkatesë të arsimit. Syllabuset përmbajnë elementët e nevojshëm që japin një përshkrim të përmbajtjes së lëndës dhe veprimtarisë që do të zhvillohet me studentin. Konkretisht kontatojmë elementët bazë:

- a. Emërtimi i lëndës;



përputhje me formatet e miratuara.

- b. *Titullari i lëndës;*
- c. *Ngarkesa;*
- d. *Lloji i lëndës;*
- e. *Adresa elektronike e titullarit;*
- f. *Kodi i Etikës;*
- g. *Përmbledhje e lëndës;*
- h. *Rezultatet e të nxënit;*
- i. *Konceptet themelore;*
- j. *Temat e lëndës;*
- k. *Metodologjia e të nxënit;*
- l. *Pjesëmarrja;*
- m. *Kontrolli i vazhdueshëm i shprehur më pikë*
- n. *Kriteret e vlerësimit: Për kriteret e vlerësimit janë paraqitur nota e shprehur me shkronjë dhe ekuivalenti përkatës i saj në notë. UNYT përdor edhe sistemin e vlerësimit me shkronjë dhe përcaktimet janë dhënë në nënin 37 të Rregullores së Programit të studimit.*
- o. *Literatura- GVJ konstaton se literatura e detyrueshme është në gjuhën angleze dhe e 10 viteve të fundit.*

GVJ shqyrtoi me vëmendje përmbajtjen e syllabuseve dhe evidenton:

1. Syllabuset në elementin “temat e lëndës: japin vetëm përshkrimin e tematikës për leksionet dhe nuk evidentojmë tematikën në lidhje me orët e ushtrimeve, orët laboratorike apo tematikën në lidhje me detyrën e kursit/projektin e kursit;
2. Në masën 95% të syllabuseve të lëndëve të detyrueshme titullari i lëndës nuk përkon me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit të paraqitur nga institucioni në dokumentin “ngarkesa vjetore” apo në dokumentin “Tabela Përmbledhëse”.
3. Në syllabuse evidentojmë angazhimin e stafit akademik nga departamente të tjera ndonëse në RVB dhe në tabelat përmbledhëse apo në tabelat e paraqitura për ngarkesat mësimore ky staf nuk paraqitet;
4. Syllabuset kanë nevojë të rifreskohen me aprovimet nga Dekani i Fakultetit dhe shefi aktual i departamentit. GVJ konstaton shumë lëndë janë firmosur nga titullar jo i duhur si shef departamenti (deklaruar si shef departamenti aktual Dr. Eriona Shtembari );

*GVJ bazuar edhe në evidencat e paraqitura rekomandon: Programet lëndore (syllabuset) kanë nevojë të rifreskohen*

	<p>duke shtuar elementin e orëve të ushtrimeve dhe praktikat laboratorike.</p> <p>Syllabuset duhet të përgatiten nga titullarët e duhur që angazhohen drejtpërdrejt në programin mësimor.</p> <p>Syllabuset duhet të aprovohen nga titullaret aktual të departamenti dhe të fakultetit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim të vazhdueshëm në masën 20%. Ndonëse ndryshimet u përmendën edhe në takimet, evidenca e gjendjes së syllabuseve tregon që ky përmirësim nuk është paraqitur dhe për më tej të përcohet tek stundeti i cili në fillim të vitit akademik njihet me përmbajtjen e tij [ev:2.14 Syllabuset e Lendeve].</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është në përputhje me përcaktimet ligjore të shprehura në VKM nr. 41, 24.01.2018. Plani mësimor përmban grupe lëndësh të ndara sipas kategorive, sipas semestrave, të ndara në ngarkesë mësimore dhe jashtë auditorit. Programi zgjat tre vite me gjashte semestra, dy në të parin, dy në vitin e dytë dhe dy në vitin e tretë. Çdo semestër ka 30 ECTS, ndërsa viti akademik 60 ECTS. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën mbi 20%. GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitur nga institucioni dhe konstaton se programet lëndore (syllabuset) kanë nevojë të rifreskohen duke shtuar elementin e orëve të ushtrimeve dhe praktikat laboratorike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënimit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është një program i cili kombinon pjesën teorike me atë praktike. Nga</p>

shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

të dhënat e paraqitur nga institucioni në programin mësimor konstatojmë një balancim midis orëve të leksionit dhe orëve të ushtrimeve. Konkretisht evidentojmë:

- Leksione: 840 orë;
- Seminare/Ushtrime/Laboratorë: 495 orë;
- Praktikë profesionale 10 orë;
- Diploma: 10 orë;
- Në total : 1355 orë në auditor;

Orët e detyrave dhe projekteve të kursit paraqiten në programin mësimor në një total 1585 orë të cilat së bashku më studimin individuale (1560 orë) që konsiderohen në orë jashtë auditorit.

	Teori	Seminare/ Ushtrime	Detyrë kursi/projekte kursi
<b>Semestri I</b>	150	75	270
<b>Semestri 2</b>	150	75	280
<b>Semestri I</b>	150	90	230
<b>Semestri 2</b>	130	60	325
<b>Semestri I</b>	150	105	230
<b>Semestri 2</b>	130	90	250
<b>Total</b>	<b>860</b>	<b>495</b>	<b>1585</b>
<b>%</b>	<b>Teori</b>	<b>Praktike</b>	
	63.4%	36.6%	
<b>%</b>	<b>29.3%</b>		<b>70.7%</b>

Programi zhvillohet gradualisht me nga 5 lëndë-module në secilin semestër, në total 10 në secilin vit akademik. Shpërndarja e krediteve shkon në raport me rëndësinë e lëndës ndonësë për lëndë si Shkrimi Akademik I dhe II I kategorisë "A" pesha e tij është 6 ECTS pothuaj e njëjtë më lëndë të kategorisë "B". Emërtimi i lëndëve lidhet drejtpërdrejt me aftësitë që studenti duhet të fitojë në përfundim të këtij programi studimi dhe të cilat përshtaten me mundësitë e punësimit të tij. Ofrimi i programit mësimor në gjuhën angleze, literaturë e viteve të fundit dhe në gjuhën angleze si edhe stafi i huaj janë disa tregues pozitivë në lidhje me cilësinë e procesit mësimor.

Ashtu siç përmendet në nenin 6 të Rregullores së Programit të Studimit "*Në përfundim të programit të studimit studentët do të jenë të aftë të familjarizohen me sistemet e informacionit të menaxhimit dhe biznesit, të aplikojnë bazat e menaxhimit dhe të financës, të jenë të aftë të zhvillojnë baza të dhënash dhe të*

	<p><i>përshtaten me teknologji të reja në fushën e inxhinierisë softëare, të databazave, të rrjeteve kompjuterike”.</i></p> <p>Studenti ka mundësinë të përparojë në drejtim të aftësisimit praktik përmes intership-it i cili zhvillohet në vitin e dytë dhe në planin mësimor është konsideruar 10 orë në auditor dhe 90 orë individuale jashtë tij. Në takimet e zhvilluara në institucion u theksua puna në lidhje me ndjekjen e studentëve në kompanitë ku ata zhvillojnë praktikën dhe vlerësimin mbi bazën e raporteve të përgatitur nga studenti dhe prezantimin e tij përpara një komisioni.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënësit.</p>	<p>Programi mesimor i ciklit të parë “Informatikë Biznesi” ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve. Ky program përmban 28 lëndë praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Organizimi i lëndëve bëhet në 5 disiplina në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (përmendur edhe në kriteret më lart). Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij të cilat GVJ i gjen të shprehur në rregulloren e programit të studimit. Programi i Studimit, lëndët-modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Në përfundim të programi të studimit studentet janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Analizojnë dhe të zhvillojnë analiza të sistemeve softëare;</li> <li>2. Të tregojnë kompetencë të lartë në teknikat e optimizimit të zgjidhjeve softëare dhe të përmirësimit të sistemeve të informacionit;</li> <li>3. Të tregojnë njohuri të sistemeve informative dhe atyre operative dhe funksionimit të tyre;</li> <li>4. Të tregojnë njohuri në projektimin e strukturave të të dhënave dhe në analizen dhe projektimin e bazave të të dhënave;</li> <li>5. Të tregojnë njohuri shumë të mirë të sistemeve softëare të biznesit dhe të të gjitha aspekteve të ciklit të plotë të proceseve të tij;</li> <li>6. Të kenë marrë njohuri në kontabilitetin financiar dhe menaxherial;</li> </ol> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët priten të kenë zhvilluar aftësi që i lejojnë ata të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Projektojnë zgjidhje konkrete për probleme ku sistemet informative janë të nevojshme;</li> <li>2. Familjarizohen me sistemet e informacionit;</li> <li>3. Aplikojnë bazat e menaxhimit dhe financës;</li> </ol>

	<p>4. Zhvillojnë programe softëare për ti dhënë zgjidhje situatë kritike;</p> <p>5. Të jenë të aftë të përvetësojnë gjuhë të reja programimi duke ju përshtatur ndryshimeve të shpejta të teknologjisë;</p> <p>6. Të mirëmbajnë sistemet informative dhe të jenë të aftë të përgatisin raporte në lidhje me to;</p> <p><i>[ev: 1.11 UNYT Mission and Objectives; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 2.3 UNYT Arsyetim për hapjen e programit Bachelor BSc në Informatikë Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor “Informatikë Biznesi” dhe e përafërt me programe të ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” aplikon një sistem vlerësimi i cili bëhet me pikë (0-100) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 0 deri në 4 dhe shprehet edhe në germa nga “F” në “A+”. Vlerësimi i programit në kredite evropiane ECTS dhe në kredite amerikane mundëson lehtësi në njohjen, ekuivalenimin dhe transferimin e studentëve në vende të tjera. Programi ka një raport të drejtë midis teorisë dhe praktikës;</p> <p><i>[ev: 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 2.1 UNYT Plani mesimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS dhe kredite amerikane lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. UNYT përcakton qartë në rregullore kriteret dhe procedurat në transferimin e studimeve.</p> <p>Për transferimin e studimeve bazuar në nenin 68 të Rregullores së UNYT merret Komisioni i Pranimeve dhe Transferimeve i cili vepron në nivel departamenti. Ky komision përbëhet nga anëtarë të cilët propozohen nga Dekanati dhe miratohen nga Senati Akademik. Komisioni ad-hoc në veprimtarinë e tij bazohet në udhëzimet e miratuara nga MARS dhe bën vlerësimet për transferimet e krediteve të aplikantëve. Mbi bazën e vendimeve të komisionit ad-hoc Zyra e Çështjeve Studentore dhe Sekretaria Mësimore njoftojnë edhe aplikantët. GVJ në vizitën e kryer në sekretarinë mësimore u njoh me procedurat e transferimit të studentëve dhe konstaton zbatimin</p>



	<p>më korrektësi të tyre nga ana e institucionit. Njohja e krediteve të transferimeve behet me vendim të njësisë bazë pas vlerësimit të përputhshmërisë së lëndëve të programit të meparshëm me atë të ri. Nga të dhënat e gjetura në sekretarinë mësimore GVJ konstaton se për vitin akademik 2021-2022, 5 studentë janë transferuar në degë të tjera brenda UNYT ndërsa për vitin 2022-2023 4 studentë janë transferuar duke ndryshuar programin [takim në Sekretarinë Mësimore].</p> <p>Programi mësimor krijon mundësi edhe për mobilitet të studentëve. GVJ në takimet e zhvilluar në institucion konfirmon se nuk ka patur mobilitet të studenteve por vetëm mobilitet të stafit akademik në kuadër të programeve Erasmus + etj [Ev: takime në institucion; dokumentacion shtesë].</p> <p>GVJ konstaton që zhvillimi i mësimit në gjuhën angleze favorizon studentët të kenë mobilitet në universitete të huaja. <u>GVJ rekomandon që institucioni duhet të zhvillojë më shumë punë për të rritur numrin e mobilitetit të studentëve.</u></p> <p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë krijimit të mundësive të studentëve për punësim në përfundim të studimeve të tyre. Zyra e Karrierës dhe Alumni, Zyra e Çështjeve Studentore përmes aktiviteteve të tyre si Panairi i Karrierës i cili kryhet çdo vit, trajnimeve dhe ofrimin të leksioneve të hapura nga perfaqësues të bizneseve të suksesshme krijon mundësi studentëve të afrohen me fushën e biznesit në lidhje me punësimin e tyre. Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” është licencuar në vitin 2020 dhe akoma nuk është përfunduar një cikël i plotë i studentëve të diplomuar. Kjo është arsyeja kryesore që GVJ nuk gjeti evidencë në lidhje me punësimin e tyre. GVJ konstaton se struktura si Zyra e Karrierës dhe Alumni janë të aftë të ndjekin punësimin e studentëve në të gjithë programet ku në vitet e ardhshme do të konsiderohen edhe studentët e diplomuar në këtë program studimi. GVJ kërkoi dokumenta shtesë në lidhje me numrin e përafërt të studentëve që priten të diplomohen dhe nga ana e institucionit është konfirmuar se 4 studentë do të diplomohen në këtë vit studimi.</p> <p>[ ev: student që priten të diplomohen-dok shtesë; 5.20 UNYT Te dhenat për punësimin e studenteve Bachelor;5.21 UNYT Dokument për transferim]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime dhe bazohet në programin e miratuar nga Ministria e Arsimit në fazën e licensimit të tij [Ev:</p>



<p>vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>2.3 UNYT Arsyetim për hapjen e programit Bachelor BSc në Informatikë Biznesi; 2.1 UNYT Plani mesimor].</p> <p>Institucioni ndjek procedurë të qartë në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të syllabuseve [Ev: 2.11 UNYT Komunikim për Syllabuse]. Takime me stafin akademik konfirmojnë punën që ata zhvillojnë në lidhje me përditësimin e syllabuseve. Bazuar në procedurat e miratuara çdo syllabus analizohet nga shefi i njësisë bazë dhe aprovohet nga Këshilli i Cilësisë. GVJ konstaton nga shqyrtimi i syllabuseve se duhet kryer punë më shumë në lidhje me pasqyrimin e tematikave të orëve të ushtrimeve dhe detyra/projekte kursi dhe një rishikim të formës së aprovimit të tyre nga drejtuesi i njësisë bazë [Ev: 2.14 Syllabuset e Lendeve; 2.14.1 Syllabus Projekti Final]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre. Studentet shprehen kënaqësi në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, organizimin e tij dhe veçanërisht dhanë mendim pozitiv për praktikën profesionale dhe mundësitë që institucioni ofron në lidhje me punësimin e tyre pas diplomimit [takim me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit. Ky departament ofron vetëm dy programe të ciklit të parë Bachelor ndërsa Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Departamenti i Ekonomikës dhe Financës ofrojnë secili programe studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave. GVJ konstaton se ndërthurja e njohurive në fushën e IT dhe Inxhinierisë Kompjuterike me njohuri në fushën e Ekonomisë u krijon mundësi studentëve të thellojnë njohuritë e tyre në programe specifike të ciklit të dytë të ofruar në institucion ose në IAL të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në takimin me studentët u konstatua dëshira e tyre për vazhdimin e studimeve të thelluara në këtë drejtim. Bashkëpunimet e vazhdueshme me sipërmarrje private dhe institucione shtetërore të lidhura nga UNYT krijojnë mundësi në punësimin e studentëve.</p> <p>[takim me stafin akademik, takim me studentët; 5.1.1 Tab 5 - Lista e MoU Informatikë Biznesi.]</p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi mesimor i ciklit të parë "Informatikë Biznesi" ka një strukturë të qartë dhe të mire organizuar të lëndëve. Ky program jep një kombinim të kuadrit teorik me praktikën.</i></p> <p><i>Programi shpreh objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij. GVJ konkludon se vlerësimi me kredite ECTS dhe kredite amerikane, ndërthurja e njohurive në fushën e IT dhe Inxhinierisë Kompjuterike me njohuri në fushën e Ekonomisë lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. GVJ rekomandon rritjen e mobilitetit të studentëve duke konsideruar që numri i tyre është i pakët.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Biznesi" që në arsyetimin e hapjes së tij është bazuar në studimin e tregut të punës dhe kërkesave të tij. Programi është në përmirësim të përmbajtjes së lëndëve dhe ndryshimet e përvitshme në syllabuse dhe në mësimdhënie kanë ardhur si pasoje e evidentimit të kërkesave nga fusha e biznesit me të cilët operojnë gjatë intershipeve apo në panairët e punës të organizuara nga institucioni. UNYT ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private ku përfutuese është edhe departamenti i Informatikës së Binesit dhe e-Biznesit për dy programet e tij.</p> <p><i>[ev: 3.14 UNYT Curricula development policy and procedures; 3.16 UNYT Studim Tregu, Alb]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e</p>	<p>UNYT përfshin studentët në procesin e vlerësimit të programit të studimit. Studentët janë aktivë në vlerësimin e lëndëve të programit mësimor përmes anketimeve që kryhen në çdo semestër. Përmes tyre ata vlerësojnë lëndën, përmbajtjen e saj, mënyrën e mësimdhënies, infrastrukturën etj. Studentët përmes klauzolave ligjore të përcaktuara në Statut janë pjesë e komisioneve të përhershme dhe janë anëtare në të gjithë</p>

<p>programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>strukturat vendimarrëse. Zyra e Karrierës dhe Alumni tregon eksperiencën në lidhje me studentët e diplomuar dhe ndjekjen e punësimit të tyre. Siç është theksuar edhe më lart ky program studimi ofron për herë të parë katër studentë të cilët priten të diplomohen dhe në këtë drejtim GVJ nuk mund të shprehë konkretisht mendim të qartë në lidhje me përthithjen e mendimit të tyre pas diplomimit për përmbajtjen e programit të studimit. Nga ana tjetër GVJ konstaton se eksperiencia që institucioni tregon kundrejt alumni në programet e tjera, zhvillimit të një anketimi dalës pas diplomimit ose për studentët të cilët ndërpresin studimet janë tregues të aftësisë që institucioni ka në këtë drejtim për vlerësimin e programit dhe cilësisë në mësimdhënie.</p> <p><i>[ev: 5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrieres; 5.12 UNYT Aktivitete Zyra e Karrieres; 5.20 UNYT Te dhenat per punesimin e studenteve Bachelor; 6.19 UNYT Perfshirja e studenteve ne Sigurimin e Cilesise]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë bën përmirësime bazuar në mendimin e studentëve të shprehur në anketimet, mendimin e stafit akademik dhe eksperiencën e fituar përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore apo vizita në kuadër të projekteve në universitete të tjera dhe marrjes së mendimit të kompanivë të biznesit ku studentët kryejnë edhe praktikat profesionale. Ndryshimet janë reflektuar edhe në analizën vjetore të njësisë bazë.</p> <p><i>[ev: 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022; 2.1 UNYT Plani mesimor]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Biznesi" është hartuar bazuar në një studim tregu i cili daton më periudhën e licënsimit të tij. Programi nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën 20%. Përmirësime të vazhdueshme janë bërë në drejtim të përmbajtjes së syllabuseve, formës së mësimdhënies. UNYT monitoron në mënyrë të rregullt procesin mësimor përmes anketimeve ku studentët janë aktivë në shprehjen e mendimit të tyre në vlerësimin e lëndëve, përmbajtjen e tyre, mënyrën e mësimdhënies, infrastrukturën etj dhe mendimet e tyre reflektohen në përmirësimet që institucioni ndërmerr.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar ligjit në fuqi, akteve nënligjiore, Rregullores së programit të studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, detyra kursi/projektet, praktikat profesionale. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes sanksionohen në Rregulloren për Programin e Studimit dhe në Syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>[ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.12.2 UNYT Ngarkesa mesimore 22-23 BI; 2.1 UNYT Plani mesimor; 2.14 Syllabuset e Lendëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>UNYT në fokus të aktivitetit të tij ka cilësinë e mësimdhënies. Në këtë drejtim inkurajon dhe mbështet të gjithë format dhe metodat në mësimdhënie të cilat garantojnë aftësimin e studentit. Dokumentat bazë që rregullojnë dhe mbështesin zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në fushën e mësimdhënies janë si vijon më poshtë:</p> <p>A. <b>Rregullore</b> e UNYT, Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Informatikës, Rregullore e njësisë bazë dhe rregullore e programit të studimit;</p>

	<p><b>B. Syllabuset:</b> Në përmbajtjen e tyre çdo pedagog përshkruan edhe format e mësimdhënies që ai synon të përdorë në lëndën e tij gjatë procesit mësimor;</p> <p><b>C. Manuali i Instruktove:</b> Ky manual i ofruar e dy gjuhe (shqip dhe anglisht) përmban udhëzime themelore për stafin akademik me kohë të plotë dhe të ftuar dhe i mundëson ata të jenë në gjendje të ndihmojnë studentët gjatë fazave të ndryshme të "procesit mësimor", dhe t'i ndihmojnë ata të kuptojnë larinë në nevojat e të nxëniet të studentëve.</p> <p><b>D. Rregullore e Projektit të Diplomimit-</b> e cila përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat e stafit akademik në lidhje me përgatitjen e temës së diplomes.</p> <p><b>E. Koordinator i programit – UNYT</b> ka hartuar edhe detyrat dhe përgjegjësitë e punës që koordinatori i programit të studimit ofron për studentët që ndjekin procesin mësimor.</p> <p><b>F. Qendra e Mbështetjes Akademike dhe Këshillimit-</b> e cila është ngritur nga institucioni dhe në fokus të veprimtarisë së saj ka studentët. Kjo qendër bashkëpunon ngushtë me shefin e njësisë bazë, Dekanin e Studentëve dhe struktura të tjera në drejtim të arrijës së suksesit akademik të studentit.</p> <p><i>[Ev:3.1 UNYT Manuali i Instruktove; 3.2 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës; 3.4 UNYT Qendra e Mbështetjes Akademike &amp; Qendra e Këshillimit].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>UNYT mbështet personelin akademik në procesim e mësimdhënies. UNYT ka hartuar edhe strategjinë për mësimdhënien dhe metodat e vlerësimit (2020-2025) e cila në fokus të saj ka:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësimdhëniën, mësimnxënia dhe metodat e vlerësimit;</li> <li>2. Transformimi dhe pasurimi i kurrikulës;</li> <li>3. Transformimi i ofrimit të programeve;</li> <li>4. Transformimi i ambienteve të mësimdhënies;</li> </ol> <p><i>[ev: 6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave të Vlerësimit].</i></p> <p>Në drejtim të zhvillimit të kompetencave të stafit akademik UNYT ofron mbështetjen përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. <b>Përmirësimit të kushteve laboratorike.</b> Sigurimi i mjedisit mësimor dhe zhvillimi i platformave të mësimimit online dhe provimeve në platforma sidomos gjatë situatës së pandemisë <i>[Ev: 3.8 UNYT Platforma e provimit në klase; 3.9 UNYT Platforma E-Provim 2020; 3.9.1 UNYT</i></li> </ol>



	<p><i>Screenshot i Platformes E-Learning; 4.18 UNYT ProProof e-Exam Platform.]</i></p> <p>b. <b>Pasurimit të fondit të bibliotekës</b> duke i dhënë mundësi studentëve të kenë qasje më shumë në drejtim të informacionit [ev; 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekes; 4.13 UNYT Ambientet e Bibliotekes]</p> <p>c. Numri i ulët i studentëve krijon edhe kushte shumë të mira për një <b>ndërveprim më aktiv pedagog-student</b> [takim me stafin akademik];</p> <p>d. <b>Mobilitet të stafit akademik</b> në projekte në kuadër të Erasmus+. Në këtë kuadër kanë përfutur mobilitet 2 pedagoge në trajnim javor [Ev: 5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota; 3.17 UNYT Erasmus + E. Shtembari; 3.17 UNYT Erasmus + I.Ayvaz 1].</p> <p>e. <b>Vlerësimi i mendimit të studentëve</b> të shprehur përmes pyetsorëve në lidhje me performancën e stafit akademik dhe stafit të ri të punësuar është një indikator për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së stafit akademik në drejtim të mësimdhënies [Ev: 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet; 6.9.1 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Spring 2021; 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022; 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022;]</p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</b></p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është më eksperiencë dhe përvojë. Në takimet e zhvilluar në institucion ata ndanë mendimin e tyre në lidhje me organizimin e orës mësimore duke i dhënë rëndësi marrjes së duhur të njohurive në teori dhe ushtrime nga studentët. Shumë lëndë zhvillohen përmes bashkimit të studentëve me grupe nga programe të tjera të cilën ata e konsideruan si pozitive në aspektin e ndarjes së njohurive dhe ecurisë sidomos në detyrat /projektet e kursit. GVJ shqyrtoi me vëmendje edhe syllabuset e hartuar nga titullaret e lëndëve dhe konstaton:</p> <p>a. Përcaktimin e qartë për çdo lëndë të objektivave të mësimnxënies;</p> <p>b. Konceptet themelore dhe tematikat e lëndëve;</p> <p>c. Metodologjia e lëndës e cila pothuaj në masën 100% është e bazuar në: leksione, seminare, konsultime, punë në grup dhe punë individuale;</p> <p>d. Kontrolli i vazhdueshëm i cili është një aspekt i rëndësishëm i vlerësuar:</p> <p>Provimi përfundimtar: 40 pike  Provimi i ndërmjetëm: 30 pike  Komponente të tjerë: 20 pike</p>



	<p>Pjesëmarrja aktive: 10 pikë</p> <p><i>[ev: 2.14 Syllabuset e Lendeve; takim me stafin akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies). Të dhënat e pyetsorëve u bëhen të njohur edhe stafit i cili bazuar në mendimin e studentëve reflekton në lidhje me ndryshimin e formës së mësimdhënies.</p> <p><i>[takim me stafin akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>UNYT i kushton një vëmendje të veçantë përthithjes së mendimit të studentëve në lidhje me procesin mësimor. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndërmerr vlerësime periodike të stafit akademik përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. pyetsorit të vlerësimit të lëndës;</li> <li>B. Formulari i vlerësimit të kolegëve;</li> </ul> <p>Rezultatet e tyre u komunikohen drejtuesve të njësisë kryesore, bazë dhe individualisht stafit akademik dhe janë objekt i diskutimeve në mbledhje. Në raportet vjetore pasqyrohet një analizë e punës dhe përmirësimet që duhet të bëhen në drejtim të procesit mësimor dhe mësimdhënies.</p> <p><i>[Ev 6.2 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2020-2021; 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022; 6.4 UNYT UNYT Formular Vleresimi nga Koleget; 6.6 UNYT Formular per Raportin Vjetor te Monitorimit.; 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet; 6.9.1 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Spring 2021; 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022; 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022; 6.9.4 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti); 6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagoqeve nga Studentet (Secilit profesor); 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form]</i></p> <p>Siç është theksuar edhe në kriterin 3 të këtij standarti UNYT ofron mundësi stafit akademik të marrë pjesë në trajnime apo konferenca në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në drejtim të procesit mësimor. Konkretisht për vitin 2022 kanë përfutuar mobilitet 2 pedagogë në trajnim javor <i>[Ev: 5.2 UNYT</i></p>

	<i>Erasmus and Mevlana Mobility Quota; 3.17 UNYT Erasmus + E. Shtembari; 3.17 UNYT Erasmus + I.Ayvaz I].</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UNYT dhe njësia bazë angazhojnë staf akademik me përvojë në fushat e mësimdhënies dhe me përvojë kërkimore. Institucioni i jep mbështetje stafit mësimor në procesin e mësimdhënies. UNYT vlerëson mendimin e studentëve në lidhje me punën e stafit akademik. Metodatat e mësimdhënies janë në përmirësime të vazhdueshme dhe njësia baze diskuton dhe analizon të dhënat e mbledhura në lidhje me mendimet e shprehura nga të anketuarit në formularin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Rregulloret në të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale lidhur me programin e studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” janë në nivel institucioni, në nivel njësie bazë dhe në nivel programi studimi, respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e UNYT;</li> <li>- Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit;</li> <li>- Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit;</li> <li>- Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”;</li> <li>- Rregullore për Projektin e Diplomës;</li> </ul> <p>GVJ u njoh me këto rregullore dhe është i mendimit se në to përcaktohen qartë elementët që lidhen me kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive.</p> <p><i>[Ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; 3.3 UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit deri në njësinë bazë si dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës [Ev:2.14 Syllabuset e Lendeve; 2.14.1 Syllabus Projekti Final; 2.1 UNYT Plani mesimor].</p> <p>Institucioni përdor edhe mekanizma të tjerë në drejtim të informimit të studentëve për programin mësimor. Përmendim këtu;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i programit mësimor, lëndët, stafin akademik në faqen e uebit;</li> <li>• Broshura, fletpalosje;</li> <li>• Java e Orientimit;</li> </ul> <p>[Ev: <a href="https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/">https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/e-business-and-e-commerce/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga komponentët si vijon më poshte përcaktuar në Rregulloren për vlerësimin e studentit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimi perfundimtar: 40 pikë;</li> <li>- Provimi i ndërmjetëm: 30 pikë;</li> <li>- Komponente të tjerë: 20 pikë;</li> <li>- Pjesëmarrja aktive: 10 pikë;</li> </ul> <p>Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse. GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitura nga ana e njësisë bazë dhe konstaton nuk janë përcaktuar qartë cilët janë komponentët e tjerë.</p> <p><i>GVJ konsideron se dhënia qartë e tematikës së ushtrimeve/ orëve laboratorike dhe vlerësimi me pikë i tyre duhet të shprehet në syllabuse dhe studentët duhet të vihen në dijeni në lidhje me të.</i></p>

	<i>[ev: 2.14 Syllabuset e Lendeve].</i>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia bazë monitoron në mënyrë të vazhdueshme stafin akademik. GVJ u njoh me indeksin e performancës për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit <i>[ev: 1.17 individual performance assessment]</i>.</p> <p>Në formularin e vlerësimit i cili plotësohet nga stafi akademik një komponent i rëndësishëm është përdorimi i platformave dixhital në procesin mësimor dhe GVJ u njoh me praktika të përdorimit të saj në lënde të ndryshme <i>[ev: 1.17 individual performance assessment]</i>.</p> <p>Njësia bazë çdo vit vlerëson edhe plotësimin e objektivave nga stafi akademik. GVJ u njoh me praktikë për vitin akademik 2022-2023 ku vlerësimi bazohet në tre kolona të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Mësimdhënie &amp; Zhvillim;</li> <li>b. Shërbimet;</li> <li>c. Kërkimi shkencor;</li> </ul> <p><i>[Ev: 1.13 annual objectives form 2022-2023]</i></p> <p>Studentët janë pjesë e procesit të vlerësimit dhe feedback-u i dhënë prej tyre analizohet në njësinë bazë dhe reflektohet në sesionin F-“Student Feedback” në raportin vjetor të njësisë bazë <i>[ev: 1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga ndërtimin e</p>	<p>UNYNT mundëson ofrimin e alternativave të ndryshme për procesin mësimor. Gjatë situatës së pandemisë mësimi u zhvillua online përmes platformës ZOOM dhe E-Exam centre për zhvillimin provimeve. Në këtë drejtim janë rikonceptuar lëndët dhe janë përdorur më shumë video-learning dhe simulime me raste konkrete ose përmes anagazhimit të më shumë lektorëve të ftuar. Në lidhje me vitin 2021 – 2022 dhe në vijim njësia bazë është fokusuar më shumë në drejtim të ndërveprimit më të ngushtë student-pedagog. Në lidhje me vlerësimin e detyrave/projekteve të kursit është futur përdorimi i Turnitin software për të kontrolluar origjinalitetin dhe autenticitetin e përmbajtjes së tyre. Studentët janë inkurajuar të përdorin platformën online të McGraë Hill. Peerson Education, Moodle etj. <i>[Ev: 1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022]</i></p>



marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore janë të përcaktuara qartë në rregulloret e hartuara dhe të miratuara nga Senati Akademik. Ndonëse format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse <u>GVJ konsideron se dhënia qartë e tematikës së ushtrimeve/ orëve laboratorike dhe vlerësimi me pikë i tyre duhet të shprehet në syllabuse dhe studentët duhet të vihen në dijeni në lidhje me të.</u></i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive janë të përcaktuar qartë në rregulloren e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit. GVJ përmes shqyrtimit të evidencave të paraqitur nga institucioni konstaton në përmbajtjen e tyre klauzola ligjore që përcaktojnë qartë format e testimit dhe mënyrën e organizimit të kontrollit dhe testimit të dijeve. Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehur qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor. Ndjekja e praktikës mësimore është e parashikuar në planin mësimor dhe zhvillohen nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Dekanati i Njësisë Kryesore. Në vlerësimin e dijes stafi akademik mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm, frekuentimin dhe pjesëmarrjes aktive në leksione, seminare, vlerësimin në detyra/projekte kursi dhe vlerësimin në provimin final. Rezultati i testimit të dijeve është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm të bërë gjatë gjithë semestrit. [ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi]</p> <p>Studentët janë të detyruar të ndjekin të paktën 75% të leksioneve, ushtrimeve dhe seminareve. Kriteret e vlerësimit të</p>

	<p>studentit për lëndën janë të shprehur në syllabus dhe u bëhen me dije studentëve në fillim të semestrit [takim me studentët: takime ne institucion; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor ne Informatike Biznesi; 2.14 Syllabuset e Lendeve ;1.7 Rregullorja e Universitetit; 2.4 UNYT Procedurat e Provimeve 2020; 2.9 UNYT Protokolli i Provimit]</p> <p>Elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, punimet/projektet dhe niveli i aktivizimit, provime të ndërmjetme etj. Format e që ndërmerren në këtë program studimi për vlerësimin e studentit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Provimi i pjesshëm;</li> <li>2. Provimi final;</li> <li>3. Riprovimi;</li> <li>4. Përmirësimi;</li> </ol> <p>Për të hyrë në provimin përfundimtar student duhet :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Të ketë të paktën 75% të pjesëmarrjes në lëndës;</li> <li>b. Të ketë hyrë në provimin e ndërmjetëm;</li> <li>c. Të ketë fituar minimum 10 pikë në total nga provimi i ndërmjete dhe aktivitetet e tjera;</li> </ol> <p>Neni 33 në rregulloren e programit të studimit përcakton edhe mundësinë e studentëve të cilët nuk marrin pjesë në provimin e ndërmjetëm dhe të drejtën e tyre për të aplikuar për mungesë të justifikuar. Neni 34 përcakton qartë edhe të drejtat për provimin në rast se zotërojnë më pak se 50 pikë. Për të kaluar një lëndë studentit duhet të ketë fituar minimum 10 pikë nga provimi përfundimtar dhe minimum 50 pikë total nga provimi i ndërmjetëm dhe aktivitetet e tjera. Për të kaluar një lëndë nota minimale është C e cila është e barabartë me 2.0/4.0 ose e konvertuar në pikë është 50/100 pikë. Njohja e studentëve me rregulloren specifike të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, format e vlerësimit dhe përmbajtja e syllabusit bëhet që në fillimin e studimeve. Programi i studimit ka edhe koordinatorin e tij i cili është përgjegjës për dhënien e asistencës te studentët në lidhje me vështirësitë që mund të hasin gjatë procesit mësimor. Në programin e studimit është futur edhe përgatitja e temës së diplomës. Në lidhje me formën e vlerësimit të tij institucioni ka përgatitur një Rregullore të veçantë [ev: 3.3 UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi” bëhet vetëm me shkrim. Në UNYT aktualisht është vënë në zbatim sistem elektronik i testimit të vlerësimit “e-Exam Center” e cila u krijua gjatë situates së covid-19 dhe funksion</p>



<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>tashmë edhe për këtë program studimi. Në lidhje me shpalljen e rezultateve të provimit studentët kanë mundësi aksesit në platformën elektronike Egonom dhe përmes përdorimit të kredencialeve personale mund të shohin rezultatet e provimeve. Përdorimi i “e-Exam Center” e cila shmang format e plagjaturës dhe abuzimit dhe rrit transparencën në vlerësimin e dijeve të studentëve nga ana e stafit akademik</p> <p>[Ev: <a href="https://examcenter.unyt.edu.al">https://examcenter.unyt.edu.al</a>; aneksi 3.8 – Platforma e provimit ne klase; 3.9.1 UNYT Screenshot i Platformes E-Learning; 3.9 UNYT Platforma E-Provim 2020].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyra dhe forma e përcaktimit të vlerësimit përfundimtar jepen qarte në Rregulloren e UNYT dhe në Rregulloren e Programit të studimit. Vlerësimi për secilën lëndë bëhet sipas raportit të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar: 40%</li> <li>• Provimi i ndërmjetëm: 30%</li> <li>• Aktivitete të tjera: 20%</li> <li>• Pjesëmarrja: 10%</li> </ul> <p>Përmbajtja e tezës për provimin e ndërmjetëm dhe përfundimtar i bëhet me dije drejtuesit të njësisë bazë dhe pasi merret aprovimi prej tij zhvillohet në provim. Kushtet e provimit jepen në Kalendarin Akademik dhe shpallen edhe në faqen zyrtare të UNYT. Për të hyrë në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë të paktën 75% të pjesëmarrjes në klasë, të ketë hyrë në provimin e ndërmjetëm dhe të ketë fituar minimumi 10 pikë në total nga provimi i ndërmjetëm dhe aktivitete të tjera.</p> <p>[Ev: takime ne institucion; 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi; 2.14 Syllabuset e Lendeve ;1.7 Rregullorja e Universitetit; 2.4 UNYT Procedurat e Provimeve 2020; 2.9 UNYT Protokolli i Provimit; 3.5 UNYT Kalendari Akademik 2022-2023]</p> <p>GVJ ndërmorri një vizitë në sekretarinë mësimore. Përmes një verifikimi të notave të hedhur në regjister me rezultatet ne procesverbalet e dhëna nga stafi akademik konstaton se studentët janë vlerësuar korrekt dhe në përputhje me nenet e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit [ev: 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni në nenin 67 “Kontrolli i dijeve” përcakton: “njohuritë e studentit vlerësohen në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentit</p>

<p>shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p><i>në formë bashkëbisedimi...” [ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi].</i></p> <p>GVJ zhvilloi një takim të veçantë me staf akademik ku këta të fundit shprehën qartë mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e studentëve. Stafi akademik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve. Në takim u theksua nga ana e tyre dhënia e feedback për çdo ushtrim apo temë që paraqet vështirësi, feedback në provimin e ndërmjetëm dhe në presantimet e detyrave/projekteve të kursit. Në çdo kohë ata janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët gjë që u pohua nga këta të fundit në takimin e zhvilluar me ta në institucion. Stafi akademik ndjek ecurinë e studentëve në intership dhe në përgatitjen e diplomave. Në mbështetje të punës së tyre kundrejt studentëve luan edhe Koordinatorin e Programit [takim me stafin akademik; takim me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UNYT i kushton vëmendje të veçantë mënyrës së vlerësimit të punimeve të studentëve, formave të kontrollit për të shmangur çdo abuzim apo plagjiaturë. GVJ gjeti evidenca të qarta të transparencës në provime. GVJ konstaton se syllabuset kanë një seksion të veçantë që i kushtohet Kodit të Etikës e cila në mënyrë rigorozë duhet të zbatohet nga çdo student. GVJ gjeti evidenca të zbatimit të programit TURNITTIN për të mos lejuar plagjiaturën në punimet e projekteve të kursit apo të diplomës nga ana e studentëve. UNYT ka hartuar edhe Kodin e Ndershmërisë së Studentit i cili përcakton qartë të gjithë penalizimet që studenti ka nëse abuzon në plagjiaturë, mashtrim, kopje. Studenti është i detyruar të firmosë këtë kod në fillim të studimeve të tij dhe bëhet me dije në lidhje me penalizimet për shkelje të kodit nga ana e tij.</p> <p><i>[3.7 UNYT Kodi i Ndershmerise se Studentit; 4.7 UNYT Kodi i Etikes; 3.8.2 UNYT Shembull i Perdorimit te Turnitin ne provimin final ne klase;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e programit Bachelor Informatikë bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e UNYT dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga diskutimet me pedagogë dhe studentë të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit. Gjithashtu, u konstatua se rezultatet jepen në kohë, bazuar në</p>

	përcaktimet e rregulloreve përkatëse [Ev. Takime në institucion].			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>UNYT përmes rregulloreve bazë përcakton qartë të drejtat e studentit për tu njohur me vlerësimin dhe të drejtën e tij për ankimin. E drejta e studentëve për tu njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim vlerësimi njihet në rregulloren e UNYT dhe te programit të studimit dhe Rregulloren e programit të studimit (neni 45). Në raste kur ka paqartësi, studenti ka të drejtë të shikojë personalisht provimin në prani të lektorit të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme studenti mund t'i drejtohet me shkrim Zyrës së Çështjeve Studentore brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. GVJ në takimin e zhvilluar me studentët konstaton njohje nga ana e tyre e procedurave për marrjen e vlerësimit brenda afatave kohore dhe të drejtën për ankimin por shembuj nga eksperiencia e tyre në këtë drejtim nuk u elaboruan [takim me studentët].</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shqyrtoi me vëmendje përmbajtjen e programit mësimor dhe evidenton se mësimdhënia bazohet në elementët baze si: leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, detyra/projekte kursi. GVJ i gjen këto elemente edhe në syllabuset për secilën lëndë. Kriteret e freuentimit, vlerësimit të njohurive të studentit dhe te drejtat dhe detyrimet e tyre janë të mirëpërcaktuar në rregulloret baze dhe ne rregulloren e programit të studimit. Studentët informohen që në fillim të procesit mësimor në lidhje me përmbajtjen e lëndës dhe asistencë që ofrohet nga stafi akademik dhe institucioni në lidhje me progresin e studentëve është e dukshme.</i></p> <p><i>UNYT përmes rregulloreve bazë përcakton qartë të drejtat e studentit për tu njohur me vlerësimin dhe të drejtën e tij për ankimin. GVJ në takimin e zhvilluar me studentët konstaton njohje nga ana e tyre e procedurave të ankimit dhe rishikimit të vlerësimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit Bachelor në Bachelor në “Informatikë Biznesi” si program studimi i Ciklit të Parë, është ndërtuar me qëllim që të mundësojë formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale. Objektivat e programit të studimit shprehin qartë synimin e formimit të studentëve përmes programit mësimor. Programi ka për qëllim të krijojë specialist të ndryshëm si menaxher projektsh, analist biznesi, analist sistemesh të informacionit, zhvillues sistemesh (softëare, databaza, ëeb etj), administrator të sistemeve apo të biznesit. Programi i studimit mundëson thellimin e njohurive përmes studimeve pasuniversitare dhe <i>GVJ sugjeron që Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit duhet të punojë në drejtim të hapjes së programit të nivelit të dytë Mastër i Shkencave në këtë profil programi.</i></p> <p><i>[ev: 2.1 UNYT Plani mesimor; 1.11 UNYT Mission and Objectives; 2.3 UNYT Arsyetim per hapjen e programit Bachelor BSc ne Informatike Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh (sipas kategorive nga A - E) të cilat në përputhje me Udhëzimet e Ligjore përmbushin kërkesat dhe detyrimet e sanksionuara. Per programin e studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” ofrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Për kategorinë “A”:</b> Shkrim akademik I dhe II të vlerësuar secila me 6 ECTS;</li><li>• <b>Për kategorinë “C”:</b> 3 lëndë me zgjedhje në nivel departamenti/ fakulteti secila me 6 ECTS dhe lëndë me zgjedhje në nivel universiteti 4 ECTS;</li><li>• <b>Për kategorinë lëndë plotësuese “D”</b> zhvillohen si lëndë me zgjedhje në nivel universiteti gjuhë e huaj I dhe II secila vlerësuar me 4 ECTS. Kryesisht si gjuhë e huaj ofrohet gjuha turke dhe GVJ u njoh me syllabuset dhe përmbajtjen e saj;</li></ul> <p>Për të mundësuar aftësimin më të mirë të studentëve në fushën e biznesit në këtë kategori ofrohet edhe lënda “Tregtia Elektronike” e cila zhvillon një spektër më të gjerë të njohurive në fushën e menaxhimit dhe tregtisë në fushën e teknologjisë elektronike.</p>



	<p>[ev: 2.1 UNYT Plani mesimor; 2.3 UNYT Arsyetim per hapjen e programit Bachelor BSc ne Informatike Biznesi]</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Syllabuset përfshijnë brenda tyre elemente shumë të rëndësishme që janë: pika 10 “Rezultatet e të nxënit”, pika 11 “Metodologjia e të nxënit” dhe pika 17 “Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës”.</p> <p>GVJ u njoh me syllabuset për secilën lëndë pjesë e kurrikulës dhe konstaton:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rezultatet e të nxënit janë ndërtuar nga stafi akademik në përputhje me përmbajtjen e lëndës;</li> <li>2. Çdo syllabus përmban vërejtje që kanë të bëjnë me ecurinë e lëndës;</li> </ol> <p>Në çdo syllabus është theksuar forma e dhënies së ndihmës në rast vështirësie nga ana e studentit. Zyra e këshillimit në UNYT dhe Qendra e Mbështetjes Akademike janë dy njësi që ofrojnë asistencë studentëve. Stafi akademik është në gadishmëri për ofrimin e çdo sqarimi dhe paqartësi që studentit mund të ketë në studime. Stafi bashkë me Këshilluesin akademik janë në dispozicion të studentëve. Të dhënat nga stafi akademik, rezultatet dhe të dhënat e mbledhura nga mendimi i studentëve të shprehur përmes anketimeve janë subjekt diskutimi dhe reflektimi në raportet vjetore të departamentit.</p> <p>[ev: 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022; 1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 1.19 Grading Transparency and Comparability Report 21-22 Shtembari + Nurja; 2.11 UNYT Komunikim per Syllabuse; 2.14 Syllabuset e Lendeve; 3.4 UNYT Qendra e Mbeshtetjes Akademike &amp; Qendra e Keshillimit]</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të</p>	<p>Mësimdhënia bazohet në format e përcaktuara në syllabus. Në metodologjinë e të nxënit konsiderohen leksionet, seminarët, orët laboratorike, konsultimet, puna në grup dhe individuale. Në zhvillimin e kompetencave të studentit organizohen edhe orë tëhapura tematika e të cilave reflektohen edhe në aneksin e raporteve vjetore të njësisë bazë. Në javën e fundit të programit zhvillohen edhe një përsëritje e njohurive dhe koncepteve themelore e cila orienton studentët në drejtim të strukturës së provimit përfundimtar [ev: 1.18 annual departmental monitoring report bi 2021-2022; 1.14 annual departmental monitoring report bi 2020-2021; 2.1 UNYT Plani mesimor; 2.14 Syllabuset e Lendeve]</p> <table border="1" data-bbox="584 1906 1366 1982"> <thead> <tr> <th data-bbox="584 1906 916 1944"></th> <th data-bbox="916 1906 1366 1944">Detyre kursi/Projekt</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="584 1944 916 1982">Semestri I</td> <td data-bbox="916 1944 1366 1982">270</td> </tr> </tbody> </table>		Detyre kursi/Projekt	Semestri I	270
	Detyre kursi/Projekt				
Semestri I	270				



përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Semestri II	280		
	Semestri I	230		
	Semestri II	325		
	Semestri I	230		
	Semestri II	250		
	Total	1585		
<b>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</b>	Stafi akademik është i angazhuar në mësim të hapura. GVJ u njoh me praktika të lektore të ftuar të cilët mbajnë tematika në përshtatje me përmbajtjen e programit mësimor dhe janë të shoqëruar nga stafi akademik PAE i njësisë bazë. Aktivitete të tjera të cilat lidhen me programin vlen të përmendet pjesëmarrja në konferenca shkencore, vizita si Vodafone për vitin akademik 2021-2022, Muzeun e Bankës së Shqipërisë apo në konkurrime ndërkombetare ku edhe janë vlerësuar me çmime [ev: aneks 2.7].			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit të cilit të parë Bachelor në "Informatikë Biznesi" synon formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale të studentëve. GVJ konstaton objektiva të qarta të programit të studimit dhe punën e stafit akademik në drejtim të përmbushjes së tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i	GVJ konstatoi se procedura për mbrojtjen e diplomës është objekt i një rregulloreje të veçantë "Rregullore e Projektit të Diplomes". Kjo rregullore si dhe elementët që lidhen me diplomimin, përgatitjen e punimit dhe mbrojtjen e saj të cilat shprehen edhe në rregulloren e UNYT, rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe në rregulloren e programit të studimit u bëhet e njohur studentëve në fillim të semestrit të fundit të studimeve Bachelor. Një vëmendje institucioni i

<p>jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>kushton plagjaturës. Neni 30 ne rregulloren e programit të studimit përmban informacion në lidhje me fazën e diplomimit. Një student që ka fituar 144 kredite (ECTS) minimale konsiderohet të jetë në fazën për tu diplomuar. Zhvillimi i praktikës profesionale është detyruese dhe pa realizuar atë studenti nuk mund të regjistrohet në Projektin e Diplomimit.</p> <p><i>[ev: 1.7 Rregullorja e Universitetit; 1.8 UNYT Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit; 1.9 Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit; 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi. Projekti i Diplomimit konsiderohet si një lëndë e veçantë e cila zhvillohet në semestrin e II të vitit të tretë. GVJ u njoh edhe me syllabusin për këtë lëndë të veçantë <i>[ev: 2.14.1 Syllabus Projekti Final]</i>. Projekti i diplomimit si një lëndë e veçantë shërben si kurs orientues në lidhje me kërkesat e shkrimit të Projektit Final. Për këtë në programin mësimor dhe në syllabus është parashikuar 10 orë në auditor (konsulta me udhëheqësin) dhe 190 orë jashtë auditorit për studim dhe punë të pavarur. Projekti final zhvillohet në formën e një studimi ku kërkime në një situatë apo në një mjedis janë detyruese. Në syllabus janë përcaktuar edhe rolet e udhëheqësit (supervizorit të temës). Në mënyrën e vlerësimit Projekti Final vlerësohet me 100 pikë. Si literaturë detyruese është dhënë “Instruksione për punimin e projektit final” dhe udhëzimet e dhëna me shkrim nga supervizori i Projektit Final. Kryesisht për punimin e temës janë angazhuar staf akademik PAE.</p> <p><i>[ev: 2.14.1 Syllabus Projekti Final; 2.5 Tabelat përmbledhese per Aneks_RVB BI; 3.2 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës; 3.3 UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit;]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ përmes shqyrtimit të përmbajtjes së programit mësimor konstaton se studenti në përfundim të studimeve i nënshtrohet punimit të diplomës ndërsa provimi i përgjithshëm përfundimtar nuk aplikohet.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Stafi akademik i ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë në lidhje me ofrimin e asistencës tek studenti gjatë përgatitjes së këtij të fundit në Projektin Final. Rregulloret kanë klauzola ligjore të veçanta në këtë drejtim. Roli i superizorit i përcaktuar edhe nga departamenti konsiston në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Inkurajimn e studentëve në shqyrtimin e literaturës së përshtatshme gjatë hulumtimit të kuadrit teorik;</li> <li>b. Përcaktimin e metodologjisë përkatëse;</li> <li>c. Përcaktimin e burimeve bibliografike, intervistave etj.</li> <li>d. Ofrimin dhe mbështetjen në drejtimin dhe udhëzimin gjatë gjithë procesit;</li> </ol> <p><i>[ev: 2.14.1 Syllabus Projekti Final; 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI; 3.2 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës; 3.3 UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit;]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike në institucion për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, mund të ofrohen mundësi për të kryer matje apo teste edhe në biznese apo institucione që mbulojnë problematikën që lidhet me temën e diplomës ose ku studentët kryejnë edhe praktikat profesionale.</p> <p><i>[takime ne institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se nota minimale është “C” e barabartë me 2.0/4.0 ose 50/100 pikë bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit. Në vlerësimin e tij konsiderohen shumë elemente të cilët janë të shprehur qartë edhe në syllabusin “Projekti Final i Diplomimit” <i>[ev: 2.14.1 Syllabus Projekti Final; 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI; 3.2 UNYT Detyrat e pedagogëve udhëheqës; 3.3 UNYT Rregullore e Projektit te Diplomimit; 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje</p>	<p>Bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studenti ka të drejtën të përftojë diplomën nëse ka plotësuar 180 ECTS dhe të ketë GPA 2.0/4.0 (50/100) në përfundim të studimeve të tij akademike. Me plotësimin e këtyre dy kriterëve studenti pajisjet me diplomë në gjuhën shqipe dhe anglisht për programin e studimit “Informatikë Biznesi”. Lëshimi i diplomës bazohet në procedura të përcaktuara nga institucioni <i>[3.6 UNYT Procedurat e Leshimit te Diplomes 2020; 3.12</i></p>

e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>UNYT Diploma Supplement 3-years bachelor ne informatike biznes].</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UNYT ka hartuar nje set me rregulla dhe procedura në lidhje me lëshimin e diplomës tek studenti në përfundim të studimeve. Procedurat e lëshimit të diplomave zhvillohen në 5 faza ku faza e fundit përcakton hapat në drejtim të arkivimit dhe listës zyrtare të notave dhe shtojcave të diplomës të studentëve të diplomuar. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për këtë dhe GVJ në vizitën e zhvilluar konstaton se ajo zbaton me korrektësi procedurat. Rregjistri i diplomave është i mbajtur në mënyrë korrekte dhe plotësuar pa vërejtje dhe shënime. Sekretaria mësimore menaxhon dokumentacionin e studentit të diplomuar. Tashmë në periudhen e regjistrimit kërkohet edhe kopje e noterizuar e diplomes së shkollës së mesme duke bërë që i gjithë dokumentacioni i studentit në përfundim të studimeve të ruhet në arkiven e UNYT dhe një kopje në Arkivën e Shtetit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi [ev: 5.5 UNYT Rregullore e Arkives; 3.6 UNYT Procedurat e Leshimit te Diplomes 2020]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi mësimor ka të shprehur qartë në rregulloren e tij procedurat për mbrojtjen e diplomës nga ana e studentit. Diplomimi realizohet përmes përgatitjes së temës studimore/kërkimore së diplomës dhe punimit të saj nga ana e studentit. Institucioni garanton një bazë laboratorike për punën e studentit në drejtim të përgatitjes së temës së diplomës. UNYT ka hartuar nje set me rregulla dhe procedura në lidhje me lëshimin e diplomës tek studenti në përfundim të studimeve. Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me diplomë në gjuhën shqipe dhe anglisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**



**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me përgjegjësën e Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” u vendos theksi që, UNYT ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Synim i së cilës është tërheqja e stafit të kualifikuar me grada e tituj shkencor (mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre), me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe rekrutimi i stafit administrativ me eksperiencë për pozicionin vakant. Finalizimi i procedurës së punësimit përmbyllet më kontratën e punës ku evidentohen element të ngarkesës mësimore, detyrimeve dhe përgjegjësi etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK;</li> <li>2. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK;</li> <li>3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 5 pedagogë nga të cilët 4 PAE dhe 1 PAK;</li> </ol> <table border="1" data-bbox="587 1592 1369 1921"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>2</b></td> <td><b>4</b></td> <td><b>1</b></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	-	-	-	-	1	Prof. Asoc.	1	1	2	-	-	-	Dr/Phd	-	1	2	-	3	-	Msc.	6	1	3	2	1	-	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	-	-	-	-	-	1																																											
Prof. Asoc.	1	1	2	-	-	-																																											
Dr/Phd	-	1	2	-	3	-																																											
Msc.	6	1	3	2	1	-																																											
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>1</b>																																											



	<p><i>Ev. 4.24 UNYT Politikat dhe Procedurat e Departamentit te Burimeve Njerezore.</i></p> <p><i>Ev. 4.25.1 UNYT Formati standart i procedures se rekrutimit.</i></p> <p><i>Ev. 1.12.2 UNYT Ngarkesa mesimore 22-23 BI.</i></p> <p><i>Ev. 4.27 UNYT Anekset e Kontratave.</i></p> <p><i>Ev. 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI, tab 6.1-6.3.</i></p>																				
<p><b>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mesimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</b></p>	<p>Nga takimi i GVJ me Zyrës së Burimeve Njerezore dhe me stafin efektiv të Departamentit për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” ngarkesa mesimore percaktohet ne kontraten individuale të punës. Kjo ngarkesë percaktohet me vendim Rektorati dhe është në përputhje me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv u shpreh gjithashtu që krahas ngarkesës në auditor është i angazhuar edhe me veprimtari të tjera mbështetëse si: tutoriati, këshillim akademik, praktikat profesionale etj.</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore (<i>ref. 2.5 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB BI, Tabelave 12.1, 12.2,12.3</i>), u konstatua se për tre vitet akademike ngarkesa mesimore e mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 1055 1359 1346"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>405</td> <td>270</td> <td>135</td> <td>67% / 33%</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>430</td> <td>370</td> <td>60</td> <td>86% / 14%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>445</td> <td>385</td> <td>60</td> <td>87% / 13%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ev. 1.12.2 UNYT Ngarkesa mesimore 22-23 BI.</i></p> <p><i>Ev. 4.27 UNYT Anekset e Kontratave.</i></p> <p><i>Ev. 4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar.</i></p> <p><i>Ev. 4.28 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar.</i></p> <p><i>Ev. 4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë te pjesshme.</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	405	270	135	67% / 33%	2021-2022	430	370	60	86% / 14%	2022-2023	445	385	60	87% / 13%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2020-2021	405	270	135	67% / 33%																	
2021-2022	430	370	60	86% / 14%																	
2022-2023	445	385	60	87% / 13%																	
<p><b>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në</b></p>	<p>Nga dokumentat e vendosura ne sistem evidentohet si edhe nga takimi i GVJ me Zyrën e Burimeve Njerezore, personeli i UNYT-së mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar si dhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Në të gjitha rastet UNYT lidh kontratën përkatëse të punës e cila bazohet në legjislacionin në</p>																				

<p>programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve. Për tre vitet akademike, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi thuajse është i njëjti duke dëshmuar në këtë mënyrë për një qëndrueshmëri të stafit akademik të brëndëshëm dhe administrativ të UNYT.</p> <p><i>Ev. 4.27 UNYT Aneksat e Kontratave.</i></p> <p><i>Ev. 4.28.2 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar.</i></p> <p><i>Ev. 4.28 UNYT Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar.</i></p> <p><i>Ev. 4.28.1 UNYT Kontratë Pune me kohë të pjesshme.</i></p> <p><i>Ev. 1.12 UNYT Ngarkesa mesimore 2020-2021 BI.</i></p> <p><i>Ev. 1.12.1 UNYT Ngarkesa mesimore 2020-2021 BI.</i></p> <p><i>Ev. 1.12.2 UNYT Ngarkesa mesimore 22-23 BI.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në vizitën që GVJ pati në institucion, stafi i burimeve njerëzore shprehet se vendet vakante për personel akademik apo administrativ bëhen publike në faqen eeb të institucionit <a href="https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/">https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/</a></p> <p>Sipas tyre, ndër kandidatët për personel akademik efektiv apo të ftuar, përzgjidhen më të mirët, duke synuar jo thjesht formimin akademik por mbi të gjitha profesionalizmin, ekspertizën dhe eksperiencën në fushat përkatëse ku ata edhe do të angazhohen në mësimdhënie. Çdo Departament përcakton nevojën për staf akademik në funksion të ngarkesës dhe të planeve mesimore të lëndëve. Njësia bazë përcakton kriteret e punësimit të cilat miratohen nga Rektori. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me konkurs nga një komision rekrutimi në bazë përbushjes së kriterëve të shpallura.</p> <p><i>Ev. 4.25 UNYT Format i shpalljes së pozicionit.</i></p> <p><i>Ev. 4.25.1 UNYT Format i standartit të procedurës së rekrutimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas</p>	<p>Mbështetur në dokumentat bazë të UNYT (statuti, rregullore, etj) personeli ndihmës akademik/laboratorik përzgjidhet me konkurs nga një Komision Vlerësimi të kandidatëve mbështetur në kriteret e shpallura dhe të vendosura nga departamenti.</p> <p>Nga vizita që GVJ zhvilloi në mjediset e laboratorit të UNYT për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi” personat përgjegjës paraqesnin formim profesional me përvojë, ekspertë të fushës dhe të suksesshëm në profesionin e tyre.</p> <p><i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.</i></p>

natyrës specifike të programit të studimit.	<p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit</i></p> <p><i>Ev. 4.3 UNYT Departamenti i Sherbimeve Mbeshtetese-Politika dhe procedura.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, nga kontrolli i dokumentacionit në dosjet e personelit akademik dhe administrativ të UNYT u evidentua që dosjet përmbanin në mënyrë të përditësuar sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dokument identifikimi;</li> <li>▪ CV-në (sipas formatit të BE-së);</li> <li>▪ Raport i aftësisë për punë/Librezë shëndetësore;</li> <li>▪ Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor (nëse ka);</li> <li>▪ Leje nga Punëdhënësi kryesor (Vetëm në rastet kur personeli akademik është I angazhuar me kohë të pjesshme në UNYT dhe full time në një IAL tjetër)</li> <li>▪ Diplomë të arsimit të lartë të kryer</li> </ul> <p>Etj.</p> <p><i>Ev. 4.27 UNYT Anekset e Kontratave.</i></p> <p><i>Ev. 4.26 UNYT Lista e Dokumenteve FT Akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit dhe planit mësimor programi i studimit përmban edhe praktike (Internship) e cila zhvillohet në vitin e dytë, në semestrin e dytë prej 4 ECTS total. Stafi akademik krahas ngarkesës mesimore zhvillon sistemin e tutorazhit dhe mbikëqyrjes studentore për zhvillimin e praktikës mësimore pranë subjekteve apo bizneseve. Këto praktika rregullohen në bazë të marrëveshjeve institucionale ndërmjet UNYT dhe bizneseve.</p> <p><i>Ev. 5.1 UNYT Lista e MoU;</i></p> <p><i>Ev. 5.1.1 Tab 5 - Lista e MoU Informatikë Biznesi;</i></p> <p><i>Ev. 1.16 UNYT Raporti i Internship;</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb;</i></p> <p><i>Ev. 2.1 UNYT Plani mesimor;</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin</p>	<p>Studentët duhet të kryejnë praktikën në një numër total orësh prej 100 orësh, në institucione apo bizneset pritëse. Në</p>

<p>pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>përfundim të praktikës, personi përgjegjës në subjektin pritës i cili ka mbikqyrur studentin, duhet të shprehet për performancën e studentit gjatë periudhës së intershipit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ nuk gjeti asnjë prëktikë për raportin final të plotësuar prej studenti që ka kryer intershipin. Gjithashtu GVJ evidentoi se nuk ka asnjë udhëzues apo syllabus për Internshipin si pjesë e planit mësimor të këtij programi studimi.</p> <p><i>GVJ sygjeron përgatitjen e nje udhëzuesi për Internshipin duke u ardhur kështu në ndihmë studentëve.</i></p> <p><i>Ev. 1.16 UNYT Raporti i Internship.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UNYT bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, trajnimit dhe stafit akademik dhe ndihmes akademike duke përzgjedhur ekspert të fushës në përshtatje me natyrën e lëndëve që programi i studimit ofron.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që mjediset (laboratorët dhe klasat për mësimdhënie) garantojnë një zhvillimin normal të veprimtarive mësimore. Mjediset nga pikpamja infrastrukturore dhe arkitektonike sigurojnë një mësim normal me standarte në drejtim të ndriçimit, lartësisë, kushteve të sigurisë në përputhje me numrin e studentëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të</p>	<p>GVJ konstatoi së të gjitha mjediset e dedikuara për mësimdhënie janë të pajisura me infrastrukture audio-vizive, internet dhe pajisje të tjera të nevojshme në ndihmë të procesit mësimor. Labororet në dispozicion të këtij programi janë 4</p>



<p>pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Laboratorë me natyre nderdisiplinore. Gjithashtu, Institucioni ka krijuar një zyrë të vecantë IT me staf të kualifikuar në këtë fushë, të cilët ofrojnë asistencën e tyre për pajisjet e teknologjisë që përdoren për mësimdhënie si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët.</p> <p><i>Ev.6 (shitesë). Relacion Arkitektonik - Infrastruktura.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënie efektiv. Gjithashtu, në varësi të aktiviteteve që mund të kryhen nga stafi akademik apo studentët, Institucioni vendos në dispozicion sallën e konferencave, e cila është e pajisur me kompjutera, vidioprojektorë, mikrofon etj.</p> <p>Laboratorët që institucioni disponon dhe që përdoren edhe për këtë program studimi, janë të pajisura me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten.</p> <p><i>Ev.6 (shitesë). Relacion Arkitektonik - Infrastruktura.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se UNYT ka në dispozicion të programit të studimit 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit me poste pune të pajisur me programe profesionale të tilla si: SPSS, Turnitin, Office 365 sikurse edhe libraritë online të tilla si: JSTOR, EMERALD.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, në dokumentacionin (<i>Ev. 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekes</i>) e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në anglisht për fushën e ekonomisë dhe informatikës. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore. Gjithashtu në çdo syllabus të secilës prej lëndëve përcaktohet literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar, në Anglisht.</p> <p><i>Ev.6 (shitesë). Relacion Arkitektonik - Infrastruktura.</i></p> <p><i>Ev. 1. Syllabuse Informatike Biznesi (3)( shitesë).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, GVJ evidenton se literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse është e viteve të fundit.</p> <p><i>Ev. 1. Syllabuse Informatike Biznesi (1).</i></p> <p><i>Ev. 1. Syllabuse Informatike Biznesi (2).</i></p> <p><i>Ev.1. Syllabuse Informatike Biznesi (3).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, Institucioni vë në dispozicion të studentëve pa pagesë bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur. Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse me një kapacitet prej 48 postesh dhe duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon me një kapacitet 12 postesh.</p> <p><i>Ev.6 (shitesë). Relacion Arkitektonik - Infrastruktura.</i></p> <p><i>Ev. 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekes</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë, në një</p>

<p>mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>total prej 8100 tituj librash akademikë dhe 8480 materiale të tjera.</p> <p>Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje (<a href="https://library.unyt.edu.al">https://library.unyt.edu.al</a> )</p> <p>Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, disa prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka akses në bibliotekën digjitale. UNYT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar të tilla si JSTOR dhe EMERALD insight.</p> <p>Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se biblioteka e institucionit ndër të tjera, është e pajisur me kompjutera (12 poste) të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar në këtë mënyrë dhe aksesimin në bibliotekat online të cilat institucioni ka abonime.</p> <p><i>Ev. 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka funksionon nga e hëna në të premte (09.00-20.00) por edhe në fundjavë (09.00-18.00) gjatë gjithë vitit akademik si edhe gjatë sezonit të provimeve duke ofruar shërbimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Huazim i librave/teksteve. Studentët mund të regjistrohen duke paraqitur një vërtetim student, fotokopje të kartës së identitetit dhe një foto;</li> <li>- Sallë studimi;</li> <li>- Hapësirë për kryerjen e detyrave apo projekteve në grup.</li> </ul> <p><i>Ev. 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p>

<p>dhe fondit online (tituj kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Cdo ditë stafi përgjegjës i bibliotekës mban të dhëna në lidhje me numrin e përdoruesve të ambienteve të bibliotekës, numrin e lexuesve, numrin e titujve të lexuar etj.. Me këto të dhëna, në fund të cdo viti akademik hartohet edhe raporti në lidhje me bibliotekën.</p> <p><i>Ev. 4.9 UNYT Politika dhe Procedura e Bibliotekës</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë. Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në UNYT garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Regjistrimit të arritjeve akademike dhe Regjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej</p>

	<p>në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA. Gjithashtu, aplikacioni në nivel institucioni i përdorur është ai GNOMON i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të menaxhimit të informacionit të Studentëve. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, regjistrimin në kurset përkatëse, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës. Sekretaria mësimore nëpërmjet këtij sistemi, administron të gjithë informacionin e studentit nga regjistrimi i tij e deri në përfundim të studimeve, për detyrimet e lëndëve, vlerësimin etj.</p> <p><i>Ev. 4.20 UNYT Platforma Gnomon.</i></p> <p><i>Ev. 4.20.1 UNYT E-Gnomon aksesit i studenteve.</i></p> <p><i>Ev. 4.20.2 UNYT Gnomon akses.</i></p> <p><i>Ev. 4.20.3 UNYT Gnomon kërkimi i studenteve.</i></p> <p><i>Ev. 4.20.6 UNYT Regjistrimi i Studentit në kurset e Semestrit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sikurse edhe nga takimi që pati në institucion, evidentoi se Institucioni mban të dhëna të cilat rinovohen çdo vit në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik sikurse edhe atë administrativ apo edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka me partner të ndryshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit. Dosjet fizike dhe elektronike të Personelit mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjithashtu në faqen zyrtare ueb të Institucionit prezantohet i gjithë aktiviteti i kryer prej stafit akademik, ndihmës akademik, studentët sikurse edhe bashkëpunimet që institucioni ka me partner të ndryshëm. Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajisen me adresë email-i personale me anë të të cilës komunikojnë në vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrative etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit, komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre dhe ndjek nrm platformës Gnomon ecurinë e tyre.</p> <p><i>Ev. 4.19 UNYT Adresa elektronike për secilin student.</i></p> <p><i>Ev. 4.21 UNYT Aksesit i profesoreve</i></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>Gjithë stafi dhe studentët e institucionit janë të pajisur me adresa email-i zyrtare duke u përdorur edhe kjo formë</p>



<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit përveç komunikimit të drejtpërdrejtë.</p> <p><i>Ev. 4.19 UNYT Adresa elektronike per secilin student.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjithashtu, përdoret edhe faja zyrtare të institucionit, ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>Në lidhje me ecurinë e studentëve, të dhënat sigurohen nga platformës Gnomon, por gjithashtu edhe sekretaria harton raporte dhe statistika të vazhdueshme.</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UNYT, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen e UNYT jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj.</p> <p>GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i></p> <p><i>Informacioni në lidhje me stafin akademik PAE, PAK dhe ndihmës akademik mbahet nga Zyra e burimeve njerëzore.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UNYT, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i></p> <p><i>Të dhënat për të gjithë studentët menaxhohen në platformën Gnomon.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UNYT raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore. UNYT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifën e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të UNYT, të ardhura nga shërbimet që ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Cdo vit institucioni finalizon pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas zërave përkatës, sikurse edhe analizën kosto efektivitet.</p> <p><i>Ev. 4.33 UNYT Pasqyrat Financiare 2020.</i></p> <p><i>Ev. 4.33.1 UNYT Pasqyrat Financiare 2021.</i></p> <p><i>Ev. 4.35 UNYT Kosto-efektivitet.</i></p> <p><i>Ev. 4.34 UNYT Procedura e Buxhetimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës.</p> <p><i>Ev. 4.31 UNYT Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit Plan Buxheti 2022-2023.xlsx.</i></p> <p><i>Ev. 4.34 UNYT Procedura e Buxhetimit.</i></p>

dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.					
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas RVB, pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e pavarur. IAL është transparent në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare përkundrejt palëve të treta, si dhe deri tani ka treguar qëndrueshmëri financiare. <i>Ev. 4.30 UNYT Raporti i Auditit te Jashtem.</i>				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në RVB, raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	UNYT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. UNYT llogarit koston për të gjithë institucionin, ashtu si dhe për programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total / shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. IAL deri tani ka treguar qëndrueshmëri financiare.				
<b>Konkluzione</b>	<i>UNYT dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se për programin e studimit “Informatikë Biznesi”, pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e njësisë bazë dhe kryesore, zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit.</i></p> <p><i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, Alb.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për cdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit. Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UNYT. Pranë UNYT, kanë të drejtë të aplikojnë dhe regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët</p>

	<p>kanë një notë mesatare nga matura shtetërore sipas legjislacionit në fuqi në vend.</p> <p>Nga takimi që GVJ pati me Sekretarinë Mësimore, evidentoi se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, në programin e studimit për vitet akademike përkatëse është :</p> <p>2020-2021 - 5 studentë;</p> <p>2021-2022 - 15 studentë (2 të crregjistruar, 5 transferim me ndryshim dege)</p> <p>2022-2023 - 19 studentë (1 i crregjistruar dhe 4 transferim me ndryshim dege)</p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit.</i></p> <p><i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, Alb.</i></p> <p><i>Ev. Vizita në institucion- Sekretaria mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të UNYT. Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në programin e studimit "Informatikë Biznesi", pedagogët u shprehën se kandidatët e interesuar mund të gjejnë informacion në lidhje me to në faqen e ueb të institucionit, duke kontaktuar me Zyrën e këshillimit të karrierës apo edhe në ditët e hapura të informimit që organizohen nga institucionet e arsimit universitar. Edhe nga studentët të cilët ishin në takim na u konfirmua se burimi i informacionit për institucionin dhe programin e studimit ka qenë faqja zyrtare ueb i institucionit.</p> <p>Në dosjen e programit të studimit në fjalë paraqiten në mënyrë të detajuar, studentët potencialë, objektivat e formimit si edhe punësimi i mundshëm i tyre. Duke qenë se gjuha e programit të studimit është anglishtja, krijon mundësi për regjistrim edhe të studentëve të huaj.</p> <p><i>Ev. 5.3.2 UNYT Kuotat për vitin akademik 2022-2023.</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, Alb.</i></p> <p><i>Ev. Vizita në institucion- takim me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatit Akademik (Ev. 5.3.2 UNYT Kuotat për vitin akademik 2022-2023).</p>




<p>përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen e internetit të UNYNT. Elementë më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit Gjithashtu Institucioni ka përcaktuar rregullat dhe procedurat për transferime</p> <p><i>Ev. 5.21 UNYNT Dokument per transferim</i>  <a href="https://unyt.edu.al/">(https://unyt.edu.al/)</a></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYNT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me studentët e këtij programi studimi, evidentohet se institucioni nëpërmjet faqes zyrtare ueb, mediave sociale si edhe TV kombëtare, informon publikun si edhe grupet e interesit në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga UNYNT si dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për tu rregjistruar në programet e studimit.</p> <p><i>Ev. RVB Bachelor ne Informatike Biznesi.</i>  <i>Ev. Vizita në institucion- takim me studentët</i>  <a href="https://unyt.edu.al">https://unyt.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UNYNT ndjek politika të mbështetje së kategorive sociale të veçanta. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga këto kategori bëhen publike para fillimit të vitit akademik në faqen ueb të institucionit (<a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a>)</p> <p>Pranimi i studentëve bazohet në aktet e brendshme rregullatore, duke përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në vartësi të programit specifik të studimit.</p> <p><i>Ev. 1.1 UNYNT Statuti i Miratuar.</i>  <i>Ev. 1.10 UNYNT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb</i>  <i>Ev. 5.30 UNYNT Provimi i Burses.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Gjuha e mësimdhënies në këtë program studimi si edhe ne programet e tjera të studimit të ofruara nga UNYNT, është në gjuhën angleze. Gjatë takimit që GVJ pati me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit si edhe me drejtuesin e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, u evidentua se numri i studentëve të huaj (që nga hapja e programit deri në këtë vit akademik) është 2 (dy)</p> <p><i>Ev. 1.10 UNYNT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb</i></p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UNYT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në UNYT. Gjithashtu institucioni ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët. Studentët e interesuar, dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së Çështjeve të Studentëve. Kjo zyrë, pas shqyrtimit të dokumentacionit vendos për përfitimin ose jo të bursës nga studentët.</p> <p><i>Ev. 5.30 UNYT Provimi i Burses.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se për programin e studimit Bsc "Informatikë Biznesi", pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UNYT, Rregulloren e UNYT dhe Rregulloren e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit "Informatikë Biznesi" realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 3 vite akademike. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite (60 për secilin vit). Studimet e këtij programi përmbyllen me projektin përfundimtar (Ev.2.1 UNYT Plani mesimor). Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të UNYT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e programit të studimit Bachelor "Informatikë Biznesi"</li> <li>- Rregullore e UNYT</li> </ul>

	<p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Neni 9 në Rregulloren e programit të studimit, jep elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për studentë në këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar edhe nëpërmjet linkut: <a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a></p> <p>Gjithashtu GVJ, e konfirmoi këtë procedurë edhe gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 5.21 UNYT Dokument per transferim.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet rregullores së programit të studimit, si edhe syllabuseve të lëndëve.</p> <p>GVJ u informua se elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et) mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb;</i></p> <p><i>Ev.2.14 Syllabuset e Lendeve, Alb;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe bazën ligjore të institucionit janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome. Për programin e studimit “Informatikë Biznesi” shlyerja e detyrimit përfundimtar, bëhet nëpërmjet projekt diplomës i cili ka 8 (tetë) kredite.</p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb.;</i></p> <p><i>Ev. 2.1 UNYT Plani mesimor</i></p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit</p>

<p>institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit e UNYT (<a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a>) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të UNYT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor për lëndët përkatëse, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre. Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse.</p> <p><i>Ev.2.14 Syllabuset e Lendeve, Alb;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se UNYT</p>

<p>studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit (<a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a>) ku pasqyrohen një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Një rol të rëndësishëm gjithashtu në informimin e studentëve luan edhe Zyra e Çështjeve të Studentëve (Ev. 5.31 UNYT SAO Rregullore e Brendshme, Alb.). Syllabuset që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë (Ev.2.14 Syllabuset e Lendeve, Alb)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në organigramën e UNYT (Ev. 1.1.1 UNYT Organigrama.), është dhe Zyra e Karrierës (Ev. 5.11 UNYT Rregullore Zyra e Karrieres, Alb.). Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Karrierës është dhe Panairi i Punës (Ev. 5.14.6 UNYT Panairi i Punes) si një aktivitet i përvitshëm dhe që jep mundësinë e zhvillimit të formës më bashkëkohore të rekrutimit të studentëve. Ai shërben si një urë e drejtpërdrejte komunikimi mes tregut të punës dhe punëkërkuessve të ardhshëm (studentëve) nga çdo fushë studimi e UNYT. Ky aktivitet është frytdhënës për të dy palët, pasi institucioni promovon studentët e tij dhe subjektet pjesëmarrëse rritin cilësisht burimet e tyre njerëzore. (Ev. 5.14.2 UNYT Lista e kompanive pjesemarrëse ne Panairin e Karrieres; Ev. 5.18 UNYT Feedback nga kompanite per punesimin e studenteve.)</p> <p>Në faqen e internetit të UNYT, në rrjetet sociale apo në ambientet e brendshme te inmtitucionit, në mënyrë të vazhdueshme publikohen njoftime për mundësi internship-i apo punësimi për studentët. GVJ, nga takimi i zhvilluar me zyrën e karrierës së UNYT si dhe nga shqyrtimi i informacionit të DVV dhe faqes së internetit, është i mendimit se lidhja me biznesin është në nivele të kënaqshme dhe se mbështetet fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimëve, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të institucionit. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohesh edhe njoftime për tarifën e studimit, bursat etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore. Gjithashtu në javën e parë të fillimit të cdo viti</p>



	<p>akademik, institucioni organizon ditët e hapura, gjatë së cilës studentët orientohen dhe informohen për gjithcka që lidhet me programin e studimit, procesin mësimor, infrastrukturën etj GVJ e gjen një praktikë të tillë në përputhje me standardin.</p> <p><i>(Ev. 5.17 UNYT Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët që regjistrohen për herë të parë pranë UNYT, pajisen me adresë emaili dhe gjithashtu kanë mundësi të aksesojnë në platformën GNOMON, në të cilën ata mund të aksesojnë informacion për ecurinë e provimeve, mungesat sikurse edhe për detyrimet financiare që ata mund të kenë ndaj Institucionit.</p> <p><i>(Ev. 4.22 UNYT Student kandidat Gnomon)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, praktikën profesionale, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni mban të dhëna të detajuara për studentët nga hyrja e deri në dalje. Gjithashtu Zyra e Karrierës dhe Alumni si dhe Sekretaria Mësimore mban të dhënë në lidhje me studentët e diplomuar si edhe punësimin e tyre. The gjitha këto të dhëna mbahen në të ashtuquajturën Dokumenti i Performancës.</p> <p><i>Ev. 5.32 UNYT Dokumenti i Performancës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e</p>	<p>Institucioni mban të dhëna të detajuara për studentët nga hyrja e deri në dalje si edhe të dhëna për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit . Gjatë vizitës në Sekretarinë</p>



<p>studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>mësimore GVJ u njoh me numrin e studentëve të pranuar në programin e studimit, konkretisht.</p> <p>2020-2021 - 5 studentë;</p> <p>2021-2022 - 15 studentë (2 të crregjistruar, 5 transferim me ndryshim dege)</p> <p>2022-2023 - 19 studentë (1 i crregjistruar dhe 4 transferim me ndryshim dege)</p> <p>Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar (regjistri bazë) i cili përmban të dhënat e detajuara për programin e studimit, formën e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme, në përputhje me Udhëzimin e MAS si edhe ligjet nëfuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Sekretaria mësimore ka aksesin e plotë në hedhjen e të dhënave të studentëve në momentin e rregjistrimit si edhe ruajtjen e të dhënave të tyre dhe hartimin e raporteve dhe statistikave që lidhen me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mban të dhënat në mënyrë manuale në rregjistra specifike, gjithashtu edhe në mënyrë elektronike. Këto të dhëna kontrollohen nga një komision dhe persona të autorizuar me Vendim Rektorati. Të gjitha të dhënat ruhen sipas rregulloreve përkatëse në UNYT.</p> <p><i>Ev. 6.20 UNYT Vendim Rektorati per Auditin e Brendeshem.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të</p>	<p>Departamenti dhe Sekretaria Mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Karrierës dhe Alumni analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti, Fakulteti apo</p>

studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. <i>(Ev. 1. LISTA E SHTOJCAVE, 2.5, Tab. 21)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të UNYT sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senatin Akademik të UMT;</li> <li>- NJBSC;</li> <li>- Komisionin Ndërdisciplinor;</li> </ul> <i>(Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të	UNYT garanton lirinë e dhënies së mendimeve apo sygjërimeve të studentëve në lidhje me vlerësimin e procesit akademik. Në fund të çdo semestri, në përfundim të çdo lënde, student npr një pyetësori japin mendimet e tyre në lidhje me performancën e çdo pedagogu, për mësimdhënien në leksione, seminare, komunikimin etj Vlerësimi nga studentët mbetet anonim dhe i gjithë informacioni i dhënë prej tyre është konfidencial. <i>(Ev. 6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet).</i>

verifikueshme e të matshme.				
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Marrja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit (Senat, NJSBC, GVB etj.) Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme.</p> <p><i>Ev. 6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagogeve nga Studentet (Secilit profesor);</i></p> <p><i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar; Ev. 6.19 UNYT Përfshirja e studenteve ne Sigurimin e Cilesise;</i></p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet;</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Për sa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimit (Ev. 5.29 UNYT Peticion Akademik). GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët për sa i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren.</p> <p><i>Evidenca: Takim me studentët;</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb;</i></p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit;</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>UNYT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, dhe në të gjitha komisionet e organizuara në UNYT si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UNYT. Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Zyra e Karrierës dhe Alumni;</li><li>- Sekretaria mësimore;</li><li>- Zyra e Çështjeve Studentore;</li></ul> <p>UNYT organizon çdo vit, për studentët e rinj, Ditët e hapura të Studentëve.</p> <p><i>Ev. 5.17 UNYT Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve</i> <i>Ev. 5.31 UNYT SAO Rregullore e Brendshme, Alb.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundur informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan edhe Zyra e Çështjeve Studentore (<i>Ev. 5.31 UNYT SAO Rregullore e Brendshme, Alb.</i>)</p> <p>GVJ konstatoi se një mjet i fuqishëm për informimin e studentëve është dhe faqja e internetit e UNYT, (<a href="https://unyt.edu.al/">https://unyt.edu.al/</a>) si edhe mediat sociale e cila përditësohet rregullisht dhe që nga studentët informohen për një seri elementësh si njoftime për mobilitete, aplikime për bursa, trajnime, internship-e, ëëbinare, trajnime, leksione të hapur etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>GVJ u informua për funksionimin në UNYT të Zyra e Karrierës. Ndër aktivitetet të cilat mbulohen nga kjo qendër mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Organizimi i leksioneve të hapura, <i>Ev. 5.12 UNYT Aktivitete Zyra e Karrierës.</i></li><li>- Organizimi i trajnimeve, ëorkshop-eve, <i>Ev. 5.14 UNYT Agjenda per Panairin e Karrierës.</i></li></ul>



informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Organizimi i Panairit të punës <i>Ev. 5.28 UNYT Panair i punes dhe studimit.</i></li> <li>– Informacion në lidhje me mobilitetet dhe bursat e studimeve jashtë vendit, <i>Ev. 5.24 UNYT Komunikim me studentet nderkombetar.</i></li> <li>– Mundësimi i internship-eve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët; <i>Ev. 5.1 UNYT Lista e MoU.</i></li> <li>– Mundësi Punësimi, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. <i>Ev. 5.18 UNYT Feedback nga kompanite per punesimin e studenteve.</i></li> </ul>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Sekretaria mësimore së bashku me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, hartojnë në fund të cdo viti akademik statistika dhe raport në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi. Këto të dhëna janë pjesë e Dokumentit të Performancës. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe anketimi për gjurmimin e studenteve i organizuar së fundmi për punësimin e studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Ev. 5.19 UNYT Punesimi i studenteve.</i></p> <p><i>Ev. 5.32 UNYT Dokumenti i Performancës.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se UNYT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UNYT.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar edhe në Strategjinë e mesimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit, ndër të tjera janë hartuar edhe planveprimet për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Një vëmendje të vecantë i kushtohet stafit akademik të ri, të cilët nuk kanë eksperiencë në mësimdhënie. Përgjegjësi i Departamentit i trajnon dhe u vë në dispozicion praktikantët në të mira të mësimdhënies.</p> <p>UNYT, ka përdorur gjatë periudhës së pandemisë përdor sistemin e-learning duke zhvilluar gjithashtu edhe zhvillimet online. Gjithashtu, aktive në UNYT, duke patur abonim të përvitshëm, studentët dhe stafi akademik kanë akses për përdorimin e bibliotekës online.</p> <p><i>Ev. 6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave të vlerësimit, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 4.18 UNYT ProProof e-Exam Platform.</i></p> <p><i>Ev. 3.8.1 UNYT Platforma e lidhjes me Mc Graë Hill.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura pranë UNYT, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik asistent lektor, vlerësohet çdo vit nëpërmjet një formulari të hartuar dhe miratuar në UNYT në lidhje me disa elementë të tilla si: komunikimi, aftësia për të punuar në grup, cilësia e mësimdhënies, risitë dhe inovacioni në mësimdhënie, kërkimi shkencor etj. Vlerësimi i stafit akademik bëhet gjithashtu nga studentët në përfundim të çdo semestri sikurse edhe nga kolegët.</p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vlerësimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vlerësimet e Pedagoqeve të rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.10 UNYT Individual Performance Assessment Form.</i></p> <p><i>Ev. 6.4 UNYT UNYT Formular Vlerësimi nga Kolegët.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>UNYT, organizon në përfundim të çdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku me përgjegjësit e grupeve mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masa për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre. Sikurse theksohen në Rregulloren e UNYT si edhe në rregulloren e</p>

<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>programit të studimit, studenti ka të drejtën e ankimimit të vlerësimit të bërë nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagogeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagogeve te rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.14 UNYT Formular per Peticion Akademik.</i></p> <p><i>Ev. 6.13 UNYT Procedura per Peticionin Akademik.</i></p> <p><i>Ev. 1.7 Rregullorja e Universitetit.</i></p> <p><i>Ev. 1.10 UNYT Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Informatike Biznesi, Alb.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sikurse edhe në kriterin më sipër, rezultatet e anketimit të studentëve u dërgohen me email cdo pedagogu, ku secili prej tyre vihet në dijeni vetëm për vlerësimin e tyre të bërë nga studentët. Më pas rezultatet diskutohen në departament. Pasi diskutohen në nivel departamenti, hartohet edhe raporti që pasi miratohet në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore. Gjithashtu vlerësimi i stafit akademik bëhet edhe nga njësia bazë nëpërmjet formularit për vlerësimin e performancës. Raporti gjithashtu shqyrton edhe analizën mësimore kërkimore në nivel departamenti sikurse edhe në nivel fakulteti.</p> <p><i>Ev. 6.9.5 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagogeve nga Studentet (Secilit profesor).</i></p> <p><i>Ev. 6.9.4 UNYT E-mail per Vleresimin e Pedagogeve nga Studentet (Rektor, Dekan, Shef Departamenti).</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Pjesë e Planit Strategjik të UNYT, ndër të tjera është zhvillimi, trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit, si në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në aspektin e kërkimit shkencor.</p> <p>UNYT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe në kuadër të projekteve Erasmus, organizon mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie ashtu sikurse edhe për trajnime. Gjithashtu pasi bëhet analiza e vlerësimit të performancës të stafit akademik, bëhet e mundur edhe promovimi i stafit.</p> <p><i>Ev. 1.6 UNYT Plani Strategjik 2020-2025, Shqip.</i></p> <p><i>Ev. 5.2 UNYT Erasmus and Mevlana Mobility Quota.</i></p>

	<i>Ev. 4.29 UNYT Vendim Senati No 67 2020 Promovim Staf.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UNYT, organizon në përfundim të cdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku më përgjegjësit e grupeve mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masta për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar Statutit, në UNYT është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Pjesë e rëndësishme e kësaj njësie është Komisionin e Perhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë dhe Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.</i> <i>Ev. 6.3 UNYT Rregullore për Komisionin e Perhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë, Alb.</i> <i>Ev. 6.7 Rregullore për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Alb.</i> <i>Ev. 6.1 UNYT Manual i Sigurimit të Cilësisë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët	Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët. Funksionimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse. Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësies së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet si edhe Komisionin e Perhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë. Në këtë Njësi përfshihen personel akademik i brendshëm i Universitetit si edhe ekspertë të jashtëm. Kjo njësi

<p>dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p><i>Ev. 6.19 UNYT Perfshirja e studenteve ne Sigurimin e Cilesise.</i></p> <p><i>Ev. 6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshëm te Cilesise, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.</i></p> <p><i>Ev. 6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNYT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. UNYT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 61, datë 18.12.2020 (<i>RVB Bachelor ne Informatike Biznesi</i>).</p> <p>Programi i studimit të Bachelor në “Informatikë në Biznes” është licencuar përmes vendimit të Urdhërit të MASR nr.198 datë 03.07.2020 dhe vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. UNYT bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, për përmirësimin e cilësisë. NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë dhe GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me NJSBC evidentoi zhvillimin e anketimeve me studentët në trajtën e pyetorëve dhe transmetimin e informacionit te drejtuesi i Departamentit. GVJ konstatoi se ka patur hartim raportesh të vlerësimit për programin e studimit shoqëruar me analizë, ku integrohen rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti si dhe është operuar me nxjerrjen e konkluzioneve të pasqyruar në raporte si dhe me plan aksioni për të adresuar problematikën e konstatuar.</p> <p><i>Ev. 1.4 UNYT Urdher nr. 198, Hapja e programit Informatike Biznesi.</i></p> <p><i>Ev. 6.19 UNYT Perfshirja e studenteve ne Sigurimin e Cilesise.</i></p> <p><i>Ev. 6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshëm te Cilesise, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.</i></p> <p><i>Ev. 6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm.</i></p>



	<p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagogeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagogeve te rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ, evidenton se në nivel institucioni, në nivel fakulteti si edhe në nivel departamenti kryhen analiza dhe raporte të përvitshme në lidhje me treguesit e performancës së stafit akademik por edhe ecurisë së programit të studimit. Synimi i këtyre analizave nuk është vetëm të evidentohen pikat e forta apo edhe mangësitë por qëllimi kryesor është të hartohen e ndërmeren plane veprimi për përmirësim. Një rol të rëndësishëm në sigurimin e të dhënave sidomos në lidhje me mësimdhënien dhe performancën e stafit akademik kanë edhe studentët e programit të studimit, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve online.</p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagogeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagogeve te rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjSBC 2021-2022.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor</p>	<p>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel</p>



<p>mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësim të mëtejshme. Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim në Senatin Akademik të UNYT.</p> <p><i>Ev. RVB Bachelor ne Informatike Biznesi</i></p> <p><i>Ev. 1.18 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sikurse evidentuam edhe në kriterin më sipër, në nivel Departamenti dhe Fakulteti kryhet analiza vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore e cila finalizohet me një raport që ndër të tjera evidenton ecurinë apo problematikat e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, bazuar edhe në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore shkencore, hartohet objektivat, plan veprimi për motivimin e praktikave të mira si edhe masat për problematikat e evidentuara.</p> <p><i>Ev. 1.18 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev. 1.13 ANNUAL OBJECTIVES FORM 2022-2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe gjate vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni përdor një sërë metodash për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit. Kështu në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti realizohet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore, vlerësohet vazhdimisht kurrikula si edhe hartohet plan veprimi për përmirësim të vazhdueshme. Studentët gjithashtu kanë rolin e tyre në vlerësimin e stafit akademik,</p>

<p>vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>nëpërmjet anketimit I cili kryhet në përfundim të çdo semestri. Performanca e stafit akademik, në bazë të disa treguesve që lidhen me mësimdhënien, kërkimin dhe angazhin e tyre, vlerësohet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p> <p><i>Ev. 1.18 ANNUAL DEPARTMENTAL MONITORING REPORT BI 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjsBC 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë. Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i lëndës nga studenti (<i>plotësohet nga çdo student përpara provimit të lëndës</i>)</li> <li>2. Vlerësimi për pedagogun (<i>plotësohet nga studenti përpara zhvillimit të provimit</i>)</li> <li>3. Vlerësimi i performancës së personelit akademik (<i>nga Drejtuesi i departamentit dhe Dekani</i>)</li> <li>4. Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut (<i>mësimdhënie, kërkim shkencor, pjesëmarrje në projekte etj</i>)</li> </ol> <p><i>Ev. 6.1 UNYT Manual i Sigurimit te Cilesise.</i></p> <p><i>Ev. 6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtem.</i></p> <p><i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vleresimi nga Studentet.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.2 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve nga studentet - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.9.3 UNYT Vleresimet e Pedagoqeve te rinj - Fall 2022.</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjsBC 2021-2022.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme. Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto</i></p>

	<i>ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Senatit Akademik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Pjesë e aktive e UNYT është edhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë. Sikurse cilësohet në Statutin e UNYT, pjesë e Komisioni të përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, janë Kryetari, 6 anëtarë staf akademik nga një anëtar për cdo Fakultet dhe studentë të cilët përzgjidhen pas procesit të vetëkandidimit sipas procedurave të përcaktuara. Ky komision ka një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mbikqyrjen për zbatim të rregulloreve, procedurave dhe politikave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për cdo program studimi. <i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Sikurse edhe përcaktohet në Statutin e UNYT, UNYT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia përgjegjëse për ta kryer këtë përgjegjësi është Njësia e Sigurimit të Cilësisë, pjesë e të cilës është NJSBC, dhe Komisioni i përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSSC).  Në Statutin e UNYT sikurse edhe në rregulloren e KPSSC përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat që studentët, stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, njësitë bazë dhe njësitë kryesore kanë për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  <i>Ev. 1.1 UNYT Statuti i Miratuar</i>  <i>Ev. 6.3 UNYT Rregullore per Komisionin e Perhershem te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise, Alb.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit,	

<p>anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ndër parimet kryesore të UNYT, të shprehura edhe në Kodin e Etikës, është edhe parimi i integritetit (parimi 6) dhe parimi i barazisë dhe respektimit reciprok të anëtarëve të universitetit (parimi 7).</p> <p>Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentat e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në Kodin e Etikës.</p> <p><i>Ev. 4.7 UNYT Kodi i Etikës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në RVB, si edhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneveve me të cilat UNYT ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës. Kjo ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu eksperiencia që stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësimin e vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj.</p> <p><i>Ev. 3.16 UNYT Studim Tregu, Alb.</i></p> <p><i>Ev. 5.2.1 UNYT Lista e MoU, Mevlana and Erasmus+Inter-Institutional Agreements.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentat e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në rregulloren e Këshillit të Etikës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ, konfirmon se përveçse dokumentacionit të plotë të vënë në dispozicion nga Institucioni në lidhje me procedurat dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në faqen eeb të UNYT, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë.</p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/</a></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions</a></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53fb">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53fb</a></p> <p><a href="https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute">https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#statute</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UNYT, në bërjen publike të informacioneve respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ashtu sikurse kemi përmendur edhe në kriteret e mësipërme, rezultatet e vlerësimeve të stafit akademik nga studentët, kolegët si edhe nga Përgjegjësi i departamentit, mbeten konfidenciale dhe nuk publikohen.</p> <p>Të dhënat në lidhje me akreditimin Institucional si dhe akreditimin e programeve të studimit të ofruara, bëhen publike në faqen ueb të Institucionit. <i>Ev. 4.7 UNYT Kodi i Etikes.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sikurse edhe është theksuar në kriteret më sipër, pasi bëhet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, hartohen edhe masat në formën e plan veprimit për përmirësimin e dobësive të evidentuara në analizën e bërë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, sikurse edhe gjatë takimit që GVJ pati me NJSBC, evidentoi se në përfundim të cdo viti akademik hartohet prej NJSBC Raporti vjetor duke evidentuar arritjet dhe mangësitë lidhur me cilësinë në UNYT në përgjithësi sikurse edhe për secilin program studimi dhe stafin akademik të angazhuar në të.</p> <p><i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjsBC 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin</p>	<p>Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të cdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata</p>



dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online. Gjithashtu stafi akademik dhe ndihmës akademik kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë. <i>Ev. 6.9 UNYT Formular Vlerësimi nga Studentet.</i> <i>Ev. 6.9.2 UNYT Vlerësimet e Pedagogeve nga studentet - Fall 2022.</i> <i>Ev. 6.9.3 UNYT Vlerësimet e Pedagogeve të rinj - Fall 2022.</i> <i>Ev. 6.2.1 UNYT Raporti Vjetor NjsBC 2021-2022.</i>			
<b>Konkluzione</b>	Në faqen web të UNYT, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë. <i>Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit) ku zhvillohet edhe programi i studimit të ciklit të parë “Informatikë Biznesi” zotëron personel akademik me përvojë dhe eksperiencë për programet mësimore;
2. UNYT ka krijuar në drejtim të programit të studimit një infrastrukturë të duhur. Procesi mësimor zhvillohet në ambiente në përputhje me standartet për salla leksioni, seminare dhe orë laboratorike;
3. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit;

4. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit disponon të gjithë rregulloret dhe informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të parë "Informatikë Biznesi";
5. UNYT ka ngritur te gjithë strukturat ne lidhje me vleresimin dhe garantimin e cilesise ne programin e studimit;
6. Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve janë të përcaktuar qartë në rregulloren e institucionit dhe zbatohen me korrektesi nga ana e tij;
7. Mësimdhënia në gjuhën angleze krijon lehtësi studentëve në drejtim të shfrytëzimit të literaturës, mobilitetit dhe punësimit të tyre në përfundim të studimeve;

**b. Pika të dobta:**

1. Numri i ulët i lëndëve me zgjedhje në fushën e informatikës; (*Standarti II.1, kriteri 3*);
2. Përmbajtja e syllabuseve duhet të përfshijë tematikat e orëve praktike dhe duhet të jenë të përgatitura nga stafi akademik i përfshirë në procesin mësimor; (*Standarti II.3, kriteri 4; Standarti III.2, kriteri 3*)

**Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon të zgjerohet numri i lëndëve më zgjedhje në fushën e informatikës në nivel departamenti;
2. GVJ rekomandon që institucioni duhet të gjejë mekanizmat e duhura për sigurimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik me kohë të plotë dhe të japë mbështetjen e duhur për rritjen e gradave shkencore të tij;
3. GVJ bazuar edhe ne evidencat e paraqitura rekomandon: Programet lëndore (syllabuset) kanë nevojë të rifreskohen duke shtuar elementin e orëve të ushtrimeve dhe praktikat laboratorike. Syllabuset duhet të përgatiten nga titullarët e duhur që angazhohen drejtpërdrejt në programin mësimor. Syllabuset duhet të aprovohen nga titullaret aktual të departamenti dhe të fakultetit;
4. GVJ rekomandon që institucioni duhet të zhvillojë më shumë punë për të rritur numrin e mobilitetit të studentëve;
5. GVJ konsideron se dhënia qartë e tematikës së ushtrimeve/ orëve laboratorike dhe vlerësimi me pikë i tyre duhet të shprehet në syllabuse dhe studentët duhet të vihen në dijeni në lidhje me të;

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Business Informatics"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The main unit (Faculty of Economics and Business) where the study program of the first cycle "Business Informatics" takes place, possess academic staff with experience for teaching program;

2. UNYT has created an appropriate infrastructure in terms of the study program. The learning process takes place in environments in accordance with the standards for lecture halls, seminars and laboratory classes;
3. To achieve the objectives of the educational process, the institution has established cooperation relations with higher education institutions inside and outside the country;
4. The Faculty of Economics and Business and the Department of Business Informatics and e-Business have all the necessary regulations and information for the organization and implementation of the first cycle study program "Business Informatics";
5. UNYT has established all the structures related to the evaluation and guarantee of quality in the study program;
6. The testing and evaluation of students' knowledge are clearly defined in the institution's regulations and are correctly implemented by it;
7. Teaching in the English language creates facility for students in terms of using literature, mobility and their employment at the end of their studies;

**b. Weaknesses:**

1. Low number of elective courses in the field of informatics; (*Standard II.1, criteria 3*)
2. The content of the syllabi must include the topics of the practical lessons and must be prepared by the academic staff involved in the teaching process; (*Standard II.3, criterion 4; Standard III.2, criteria 3*)

**Recommendation**

1. EEG recommends expanding the number of elective courses in the field of informatics at the departmental level;
2. EEG recommends that the institution should find appropriate mechanisms for ensuring the sustainability of full-time academic staff and provide supporting mechanism for the growth of their scientific ranks;
3. The syllabus need to be updated by including the element of exercise hours and laboratory practices. Syllabus should be prepared by respectively academic staff directly engaged in the curriculum. Syllabus must be approved by the current department and faculty heads;
4. EEG recommends that the institution should develop more work to increase the number of student mobility;
5. EEG considers that providing the thematic of exercises/laboratory hours and their assessment with points should be expressed in the syllabus and students need to be informed about it;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X